

Intimiteti në martesë

Duke njohur veten, duke të njohur ty

Shumë njerëz sot përballen me një krizë për të cilën ata patjetër që do të pendohen në marrëdhëniet e ardhshme. Kriza është ajo e intimitetit. Sjellja e rastësishme në lidhje me intimitetin dëshmon se ekziston një pështjellim në lidhje me atë që është sjellje normale në një marrëdhënie. Kur dikush luan me këto ndjenja dhe ka një qëndrim të shkujdesur ndaj intimitetit, ai priret të rritet pa pasur një kuptim të vërtetë për intimitetin. Dëshiroj të shohim së bashku se çfarë do të thotë intimiteti në një martesë.

Kjo është një temë që shpesh shmanget, për shkak se është kaq vetjake. Po ashtu është një temë e cila shumë shpesh është keqkuptuar. Intimiteti në një martesë! Dua t'i drejtojmë mendimet tona për të marrë parasysh tri gjëra: (a) Çfarë nuk është intimiteti? (b) Çfarë është intimiteti? (c) Si mund të rritemi në intimitetin martesor? E gjitha kjo bazohet në parime biblike për intimitetin në martesë.

Çfarë nuk është intimiteti

Në kundërshtim me mesazhin e botës dhe të kohës në të cilën jetojmë, intimiteti nuk është thjesht marrëdhënia seksuale. Po, marrëdhënia seksuale është dhënë nga Perëndia dhe është një pjesë e bukur e marrëdhënies martesore, por intimiteti shkon shumë më thellë. Nëse është vetëm aspekti fizik, do të thotë që është thjesht plotësimi i një dëshire/nevoje fizike ose, në shumë raste, plotësimi i epshit. Intimiteti nuk vjen vetvetiu kur martohesh. Besoj se ka shumë çifte që janë të bllokuar në një martesë ku mungon intimiteti i vërtetë dhe ku dashuria nuk është e pranishme. Ka mundësi të martohesh e, megjithatë, të bësh një jetë shumë të vetmuar pa pasur asnjë person që të njeh, të do dhe të vlerëson me të vërtetë.

Libri "Sekreti i dashurisë" (The Secret of Loving) e bën shumë të qartë

që, nëse dashuria juaj është e bazuar vetëm në tërheqjen fizike dhe marrëdhënien seksuale, me shumë mundësi ajo është e caktuar të mos zgjasë për një kohë të gjatë! Ndonëse kjo mund të jetë emocionuese për një farë kohe, nuk i bën ballë provës së kohës ose sfidave dhe vështirësive që jeta do të sjellë në rrugën tuaj. Çfarë do të ndodhë kur sëmundjet e ndryshme ose kalimi i moshës do të cenojnë anën fizike; a do të jetë dashuria juaj aq e fortë dhe e thellë? A do t'i çmoni ende kohërat tuaja intime së bashku, edhe sikur kjo do të thotë thjesht të qenët së bashku, pa aspektin fizik?

Çfarë është intimiteti

Intimiteti do të thotë një marrëdhënie shumë e afërt, private dhe vetjake mes një bashkëshorti dhe një bashkëshorteje. Jemi duke folur këtu për dy njerëz që e njohin shumë mirë njëri-tjetrin, njohin zakonet, pëlqimet dhe mospëlqimet, shpresat dhe pritjet e njëri-tjetrit, ashtu sikurse kanë një njohje vetjake dhe private të trupave të njëri-tjetrit.

Natyrisht, ka nivele të ndryshme të intimitetit. Ne kemi miqësi shumë të afërta, vetjake me të tjerët, të cilët nuk janë pjesë e marrëdhënies intime martesore. Gjithsesi, marrëdhënia më intime në të cilën do të hyni ndonjëherë, në nivelin njerëzor, është ajo mes një bashkëshorti dhe bashkëshorteje në një martesë. Kjo marrëdhënie shumë intime është një mister për ata që nuk janë pjesë e saj. Fjalët e Urta 30:18, 19 thonë për këtë gjë: ... "Ka tri gjëra tepër të mrekullueshme për mua, madje katër, që unë nuk i kuptoj: ... dhe udha e burrit me një vajzë." Ka një aureolë misteri dhe çudie rreth gjithë procesit të njohjes së një burri dhe një gruaje: koha e propozimit, fejesa, ceremonia e martesës dhe pastaj përmbushja e atij zotimi të besnikërisë, derisa vdekja t'i ndajë! Vetëm ju dhe bashkëshorti/bash-

këshortja juaj e dini çfarë ndodh mes jush kur jeni vetëm. Ky është intimiteti. Diçka kaq e veçantë që është unike për ju të dy! Nuk ndahet me të tjerët!

Do të doja të shtoja një fjalë në lidhje me temën e veshjes. Fatkeqësisht shoqëria që na rrethon, edhe media, TV, filmat etj., janë duke dhënë një shembull shumë negativ se si duhet të vishet një grua. 1 Timoteu 2:9 thotë: "Po ashtu edhe gratë, të stolisin veten e tyre me rroba të ndershme, me cipë dhe modesti...". Çfarë do të thotë kjo për ne sot? Besoj se kjo është një nxitje për ne gratë që të vishemi në mënyrë femërore, por jo në mënyrë provokuese! Nëse trupi yt si grua është vetëm për burrin tënd, mos ia reklamo atë botës! Përveç bashkëshortit tënd, një gjë e tillë tërheq në epsh zemrat e burrave të tjerë dhe mundet, fare lehtë, të çojë në një marrëdhënie fizike jashtëmartesore. Perëndia e quan këtë mëkat! Vishu në një mënyrë që të mos ndihesh keq në publik dhe që as ti dhe as bashkëshorti yt të mos ndiheni në siklet. Në këtë mënyrë ju do të jeni duke i nderuar standardet e Perëndisë.

Intimiteti përfshin besim! Kemi folur për këtë në numrat e mëparshëm të revistës "Ilira", por më lejoni ta theksoj edhe një herë: Nuk mund të ketë intimitet të vërtetë nëse dyshimi ose mosbesimi janë të pranishëm në marrëdhënie! Kjo është shumë e rëndësishme. Dy njerëz, që janë me të vërtetë intimë me njëri-tjetrin, kanë nevojë të dinë që ata janë tërësisht të sigurt! Të njohësh intimitetin e vërtetë, duhet të përgatitesh ta bësh veten tërësisht të cenusshëm ndaj këtij personi, i cili është bashkëshorti/bashkëshortja jote. Një pyetje për ju që jeni të martuar: A jeni tërësisht të lirë nga frika për t'i treguar diçka bashkëshortit/bashkëshortes suaj? Ose a mbani për vete gjëra, qoftë mendime, plane, ëndrra ose vetë trupin tuaj?

Një pasazh në Bibël, që flet shumë qartë për aspektin fizik të martesës është

1 Korintasve 7:2-5. Ky pasazh na mëson shumë qartë që një bashkëshort dhe një bashkëshorte ka një detyrë martesore për të përmbushur. Kjo gjë nuk është një mundësi për të zgjedhur. Kur ne martohemi, trupat tanë nuk i përkasin më vetes sonë, por bashkëshortit/bashkëshortes. Këtu ne nxitemi që të mos ia heqim bashkëshortit/bashkëshortes të drejtën e kësaj, përveç rasteve të një marrëveshjeje të përbashkët dhe, veç kësaj, vetëm për një kohë! Pastaj çifti duhet të bashkohet sërish në mënyrë që të mos e lejojë djallin t'i tundojë sërish për të mëkatuar! Efesianëve 5:28-31 mëson që në aktin fizik burri dhe gruaja bëhen një mish, pra ata bëhen pjesë e njëri-tjetrit. Një fjalë nga Hebrenjve 13:4 thotë: “Martesa të nderohet nga të gjithë, dhe shtrati martesor të jetë i papërlyer, sepse Perëndia do të gjykojë kurvarët dhe kurorëshkelësit.”

Më lejoni ta them sërish – nuk duhet të ketë marrëdhënie TJETËR fizike; vetëm ajo që Perëndia ka paracaktuar mes teje dhe bashkëshortit/bashkëshortes! Akti fizik është paracaktuar nga Perëndia dhe është i mirë, i drejtë dhe i bukur brenda kontekstit të një burri dhe një gruaje të martuar me njëri-tjetrin. Çdo gjë tjetër është mëkat dhe e pakënaqshme për Perëndinë.

Kjo është pjesë përbërëse e intimitetit brenda martesës, por nuk duhet të ndahet nga aspekti i njohjes së vërtetë të njëri-tjetrit në nivelin shpirtëror. Këto të dyja janë të gërshetuara ngushtë dhe nuk mund të kemi intimitet të vërtetë fizik pa pasur njohjen e thellë të bashkëshortit/bashkëshortes në nivelin shpirtëror të marrëdhënies.

Si mund të rritemi në intimitet?

Nëse ky intimitet i vërtetë është duke munguar, si mund ta bëni që të rritet? Ja disa sugjerime të cilat shpresoj se mund t'ju ndihmojnë në një martesë të përmbushur. Ndërmerrni hapa për ta njohur me të vërtetë bashkëshortin/bashkëshorten. Ne kemi një libër në shqip të quajtur “Pesë gjuhët e dashurisë” (The Five Love Languages). Këtu përmenden pesë hapa, si: 1) Fjalë pohuese, 2) Kohë cilësore, 3) Pranimi i dhuratave, 4) Vepra shërbimi dhe 5) Prekja fizike. Ju mund të jeni në gjendje të mendoni edhe për të tjera, por përdorini këto si bazë për të ditur se për çfarë ajo/ai gjen

kënaqësi, çfarë i intereson atij/asaj etj.

Mëso çfarë e kënaq bashkëshortin/bashkëshorten tënde dhe përpiku t'i plotësosh këto nevoja. E gërshetuar me këtë dhe me njohjen e bashkëshortit/bashkëshortes është edhe komunikimi! Flisni! Flisni! Flisni me njëri-tjetrin! Gjeneroni kohë për të bërë biseda të vërteta, jo vetëm për ditën e punës, fëmijët etj., por për zemrën, emocionet tuaja, çfarë je duke mësuar nga librat e Biblës etj. Intimiteti i vërtetë vjen kur jeni tërësisht të lirë nga frika për t'i treguar atë që është në zemrën tënde bashkëshortit/bashkëshortes. A e ke përjetuar ndonjëherë atë përvojën që e di çfarë do të thotë bashkëshorti/bashkëshortja ose përvojën e komunikimit pa fjalë? Nëse është kështu, ju po mësoni të jetoni në intimitet me njëri-tjetrin!

Ja disa mënyra praktike se si ta bëni dashurinë tuaj të rritet në intimitet:

Kaloni kohë së bashku në biseda të rëndësishme, ku eksploroni mendimet dhe ëndrrat e njëri-tjetrit, t'i tregoni njëri-tjetrit çfarë keni qenë duke mësuar nga Shkrimet etj. Kjo do të thotë të ruani për njëri-tjetrin një kohë së bashku pa shpërqendrim. Çfarë mendimi keni për një takim, të dilni për kafe ose për të bërë një shëtitje, një herë në javë?

Qerasje për ne, për mua dhe bashkëshortin tim, është të mos e vëmë zilen e zgjimit të shtunën në mëngjes dhe pas kësaj një kohë çlodhjeje, duke e pirë kafën së bashku në ballkon.

Mua më bënte kaq shumë përshtypje praktika e një prej ish-drejtuesve të misionit – ai caktonte në agjendë çdo javë një kohë për gruan e tij, kohë për familjen e tij. Nëse dikush e telefononte që të linte një takim ose ndonjë angazhim tjetër, ai e kontrollonte agjendën e tij dhe thoshte: “Më vjen keq por ajo pasdite/mbrëmje tashmë është e zënë.” Bëjeni këtë një praktikë në jetën tuaj! Një angazhim i kësaj natyre do t'ju ndihmojë në procesin e ndërtimit të intimitetit dhe po ashtu në rritjen e dashurisë së ndërsjellë. Bëjeni njëri-tjetrit dhurata të vogla domethënëse dhe të papritura. Nuk është e nevojshme që këto të kushtojnë! Burri im shpesh, veçanërisht gjatë kohës së pranverës, më befason me një buqetë të bukur lulesh, të cilat i ka këputur gjatë rrugës për në shtëpi nga ndonjë udhëtim. Kjo



ka më shumë domethënie sesa ndonjë buqetë e shtrenjtë e blerë! Mëso se çfarë e bën bashkëshortin/bashkëshorten të buzëqeshë dhe bekoje atë!

Për të testuar nivelin tuaj të intimitetit, si çift, mendoni për pyetjet që vijojnë: A jeni të lumtur kur jeni bashkë, pa njerëz të tjerë përreth? A i shijoni pushimet bashkë? A jeni të etur për të shkuar në shtëpi, pas një dite kur keni qenë larg? Sa të shpejtë janë hapat e tu drejt shtëpisë dhe drejt njeriut me të cilin je martuar? A mërzhiteni shpejt me njëri-tjetrin, apo a vazhdoni ende të befasoheni nga gjërat e reja që po mësoni?

Ti mund të mendosh se e njeh personin me të cilin po martohesh ndërkohë që qëndron pranë tij ditën e dasmës! Gjithsesi, ky është thjesht hapi i parë në këtë udhëtim që zgjat gjithë jetën!! Shumë çifte që kanë pasur martesë të gjata dhe të lumtura thonë që e kanë njohur bashkëshortin/bashkëshorten në një mënyrë shumë më intime tani pas 10, 20, 30, 50 etj. vitesh martesë! Dashuria e tyre është thelluar me kalimin e viteve të jetës së bashku. Intimiteti rritet me kohën. Është një udhëtim jete i njohjes së njëri-tjetrit më mirë, i thellimit të dashurisë suaj për njëri-tjetrin.

Lexime të rekomanduara

- “5 gjuhët e dashurisë” nga Gary Chapman. “Shigjeta”
- “Sekreti i dashurisë” nga Josh McDowell “OM”
- “Seksi dhe martesë” nga June Hunt “Radio 7”

Përktheu Erjon Ramaj



Çfarë duan femrat

Të dashur miq dhe mikeshë,
Përpara se të përgatitja këtë shkrim, bëra një pyetësor të thjeshtë me temën: “Çfarë duan femrat? dhe disa nga përgjigjet që mora nga të intervistuarit meshkuj ishin këto:

Femrat duan: para, pushtet, luks, pushime të shtrenjta, rroba firmato, dado për fëmijët dhe “grua” për të bërë punët e shtëpisë, vëmendje, llastime, një shtëpi në plazh etj.

Kur i lexon këto mendime për femrat, të zë frika, sepse ato paraqiten si

krijesa që të trembin, që të shkaktojnë vuajtje dhe “shpenzimë të mëdha”. Në fakt, femrat megjithëse duken qenie shumë të ndërlukuara dhe të “padeshifruara” nga meshkujt (duke cituar disa nga opinionet mashkullore), kanë disa nevoja thelbësore, të cilat nuk kushtojnë asnjë qindarkë për t’u plotësuar nga ana e meshkujve.

Madje mendoj që vetë meshkujt, nëse do t’i njihnin këto nevoja thelbësore të femrave dhe do të përpiqeshin sadopak për t’i plotësuar, do të habiteshin mbi

ndikimin që do të kishte kjo në marrëdhënien dhe në martesën e tyre.

Femrat kanë nevojë për dashuri e ngrohtësi dhe ngrohtësia është themeli i nevojshëm i marrëdhënies së tyre dashurore. Për pjesën dërrmuese të femrave, ngrohtësia barazohet me sigurinë, mbështetjen, mbrojtjen, rehatinë dhe miratimin nga ana e partnerit. Kur bashkëshorti i ofron gruas së tij ngrohtësi, ai është duke i dërguar asaj mesazhe, si:

- Unë do të kujdesem për ty, ndaj mos ki frikë! Je shumë e rëndësishme për mua!
- Në çdo hap që hedh, më ke me vete!
- Mendoj se je e mrekullueshme dhe kjo më bën mua një burrë me fat.

Ka meshkuj që nuk mund të shprehën si në një roman, por pa dyshim që dinë të dhurojnë një përqaftim. Një përqaftim, në fakt, i thotë mjaft qartë të gjitha ato që listova më sipër. Femrat i kanë shumë qejf përqaftimet, pasi ato përqafojnë gjithë kohën fëmijët e tyre, mikeshat, kushërinjtë, kafshët shtëpiake etj. Ndaj burrat duhet të mësojnë që t’u tregojnë bashkëshorteve të tyre pak ngrohtësi përmes përqaftimeve.

Një kartolinë apo një shënim që ju, burra, mund t’u shkruani bashkëshorteve tuaja, ka të njëjtin efekt si një përqaftim. Me fjalë të thjeshta dhe të sinqerta shprehuni bashkëshorteve tuaja, dashurinë dhe admirimin që ndieni për to.

Herë pas here femrave iu pëlqen që të marrin lule. Tani është bërë edhe më e lehtë që të gjesh lule të freskëta në rrugët e qytetit. Për shumë femra, lulet përçojnë një mesazh të fuqishëm dashurie dhe kujdesi. Mos ki turp të mbash në dorë një tufë lulësh që do t’i sillte shumë gëzim së shtrenjtës sate, që mezi pret që të kthehesh ne shtëpi.

Sipas mundësive financiare, ftojini bashkëshortet tuaja për një vakt jashtë në restorant. Me anë të këtij veprimi ju i shprehni mirënjohjen për kujdesin e përditshëm që ato tregojnë ndaj jush.

Hej, lexues “djema”, ne femrave na pëlqen që ndonjë ditë, krejt papritur, të shijojmë një vakt jashtë e të mos i shohim me sy tenxheret dhe tiganët. Nëse nuk keni mundësi që të shkoni në restorant, përgatitini bashkëshortes suaj një kafe apo një çaj dhe shërbejani edhe me ca biskota apo ndonjë ëmbëlsirë të

Një herë vajza e pyeti të ëmën pse ajo e piqte pulën në dy tava. "Sepse kështu e piqte gjyshja jote", ia ktheu e ëma. Atëherë vajza e pyeti gjyshen pse ajo e piqte pulën në dy tava.

"Ah, moj bijë, në kohën tonë nuk kishte tava mjaft të mëdha, prandaj e ndanim pulën në dy pjesë", ia ktheu gjyshja.

Kjo histori na kujton për një tjetër trashëgimi, atë të pavetëdijshtmen. Ne sjellim pa kuptuar në martesat tona një "valixhe sjelljesh dhe zakonesh" dhe të njëjtën gjë do ta bëjnë edhe vajzat tona. Martesa jonë, familja jonë është modeli i familjes që ato kanë parë më nga afër dhe modeli që do të marrin me vete. Në këtë aspekt, një nënë që e do babanë e fëmijëve të saj (dhe anasjelltas) është një dhuratë e paçmuar për fëmijët.

Një nënë që e do babanë e fëmijëve të saj bën një investim në brezat që do të vijnë. Por shpesh na ndodh të sillemi me bashkëshortët, pa e kuptuar, në të njëjtën mënyrë si nënat tona silleshin me etërit tanë. Por nëse ne e duam dhe e respektojmë bashkëshortin tonë, në të njëjtën kohë do të jemi duke mësuar dhe modeluar edhe tek vajza jonë dashurinë për bashkëshortin, dhe përmes saj edhe tek brezat që do të vijnë.

Prandaj përgjegjësia jonë është e madhe për komentet që bëjmë për bashkëshortët dhe qëndrimin që kemi ndaj tyre. Ja si mund ta shprehësh dashurinë ndaj tij:

1. Respektoje atë,
2. Lavdëroje shpesh në sy të fëmijëve,
3. Shpreh para tyre parapëlqimin tënd për atin e familjes.

Para disa kohësh kisha një mikeshë për vizitë në shtëpi. Vajza e saj i kërkoi t'i blinte një akulllore, por meqë dyqani ishte larg, mikeshja ime i tha se nuk do të shkonte aq larg në atë kohë për të blerë akullloren.

"Po sikur të dojë babi?", e pyeti vajza.

"Atëherë për babin do të shkoj", iu përgjigj mikja ime.

Fëmijët duhet të kuptojnë që mami e do babin e tyre mbi gjithë njerëzit e tjerë, edhe mbi ata vetë dhe se ata në fakt nuk janë qendra e botës.

4. Lutu për të bashkë me fëmijët.

Sa njerëz po luten për bashkëshortin tuaj sot? Ndërsa burrat përballen

sot me botën dhe sigurojnë të ardhurat për familjen, ata kanë nevojë për lutjet tona. Mua më ka ndihmuar një kartolinë e thjeshtë lutjeje që e mbaj në Biblën time. Është një gjë shumë e thjeshtë për t'u bërë çdo ditë. Pasi lutesh për të, thellohen edhe ndjenjat pozitive dhe rritet dashuria dhe dhembshuria për mikun tuaj të jetës. Lutu për të; në fakt lutu për të bashkë me fëmijët.

Së fundmi dhe më e rëndësishmja, thesari më i çmuar që mund t'i lësh vajzës sate është: DISHEPULLOJE - mësoje të njohë Krishtin dhe të dojë fjalën e Tij.

Jeremia 9:23-24 «Kështu thotë ZOTI: "I urti të mos lavdërohet me urtësinë e tij, njeriu i fortë të mos lavdërohet me forcën e tij, i pasuri të mos lavdërohet me pasurinë e tij. Po kush lavdërohet, të lavdërohet me këtë: të ketë gjykim dhe të më njohë mua që jam ZOTI, që ushtrij mirësinë, gjykimin dhe drejtësinë mbi tokë; sepse kënaqem me këto gjëra", thotë ZOTI.»

Kultura sot ushtron shumë presion se si fëmijët duhet të pajisen për të pasur sukses, të shkojnë në shkollat më të mira, në universitetet më të njohura, të njohin shumë gjuhë të huaja. Sa shumë kohë e energji investojmë për kurset e ndryshme, si p.sh. tenis, piano, balet, pikturë etj. Ne duam që fëmijët tanë, vajzat tona të jetojnë kapacitetin e tyre të plotë intelektual dhe të jenë të suksesshme në jetë. Pyetje si: "Çfarë do të bëhet fëmija im? A do të jetë ai/ajo i suksesshëm në jetë?", i kemi si çekiç në kokë herë pas here. Përveç kësaj, nuk matemi dot me gjithë morinë e lodrave, ipad, ipod, laptopave dhe duam që ata të mos ndihen të privuar nga gjithë këto gjëra.

Por çfarë çlirimi vjen kur lexon Fjalën e Zotit! Më e rëndësishmja nga të tëra është të njohin Atë.

Nuk po them se është gabim ta ndihmosh fëmijën tënd të zhvillohet intelektualisht dhe të sigurosh mënyra si të zbulojë e të zhvillojë talentet që Perëndia i ka dhënë, por parësore është të njohë Zotin dhe të tjerat (që ne pa e kuptuar në jetën e përditshme i bëjmë të parat) janë dytësore.

Më kujtohet që kur isha 10-11 vjeç, babi bleu disa kapëse flokësh me gurë, varëse dhe bizhuteri të tjera, që në atë kohë konsideroheshin me vlerë. Mami

NJË NËNË QË E DO BABANË E FËMIJËVE TË SAJ BËN NJË INVESTIM NË BREZAT QË DO TË VIJNË.

nuk na linte mua dhe motrën t'i vinim, sepse donte që "t'i kishim kur të rriteshim".

Kur ne u rritëm, nëpër dyqane kishte kaq shumë varëse e kapëse flokësh, saqë ne, në fakt, asnjëherë nuk i shijuam ato që babi na kishte blerë atëherë.

Pasuritë, intelekti, sukcesi shoqëror janë në duart e Perëndisë. Të mbledhësh "pasuri në tokë, ku i bren tenja dhe ndryshku" nuk është trashëgimi që do të zgjasë.

Njohja e Perëndisë dhe të kuptuarit e Tij është trashëgimia më e vlefshme që unë dëshiroj t'i lë vajzës sime.

Është një dritare kohe në jetën e vajzave (para se të fillojnë hormonet e adoleshencës), ku ato i duan dhe adhurrojnë nënat e tyre. Fillojnë vishen si nëna e tyre dhe duan të gatuajnë si ato. Duhet ta shfrytëzojmë këtë kohë për të ndërtuar zakone që ato do t'i kenë për gjithë jetën.

Nëse unë dua që ime bijë të ndjekë Zotin, duhet ta ndjek dhe ta njoh Atë. Duhet të bëhem shembulli që ajo ndjek.

Ndërsa lexoj fjalët që këto vajza dikur të vogla, tashmë të rritura dhe disa prej tyre nëna, kanë shkruar, po mendoj çfarë dua unë të shkruajnë vajzat e mia (njëra 9 vjeç dhe tjetra e sapolindur) për nënën e tyre.

Ajo që do të doja patjetër të shkruajnë është "nëna jonë nuk ishte e përsosur, por ajo e lexonte Biblën dhe lutej çdo mëngjes. Na mësoi si të duam Zotin dhe ta studiojmë Fjalën e Tij."

Bashkudhëtare me ju në prindërim, "Nëse Zoti nuk ndërton shtëpinë, më kot lodhen punëtorët."

*Shkroi dhe përgatiti,
Maklen Menalla,
Jetë Familjare*



I ntimiteti

Pjesa e dytë

Shumë pak gjëra në jetë kanë aq forcë për të na sjellë lumturi, sa marrëdhëniet familjare. Anasjelltas, shumë pak gjëra mund të na sjellin dhimbje sa marrëdhëniet e shkatërruara familjare. Familja e ka humbur udhën e saj, familja është sulmuar nga zëra kontradiktorë. Çdo gjë që ndodh në familje ndikon mbi kombin, madje edhe mbi botën mbarë, për mirë ose për keq.

Një karakteristikë e dytë e një familje të shëndetshme është ekzistenca e intimitetit midis burrit dhe gruas. Bashkuam emrat tanë sepse dëshironim të bashkonim jetët tona në një ëndërr të përbashkët të lumturisë. Fjala intimitet vjen nga latinishtja *intimus*, e cila do të thotë "i brendshëm". Kështu intimiteti përfshin 2 njerëz, të cilët zbulojnë botën e tyre të brendshme para njëri-tjetrit. Intimitet do të thotë të hysh në jetën e njëri-tjetrit emocionalisht, në mënyrë intelektuale, shoqërore, fizike dhe frymërore. Intimiteti lidh thellë çdo nivel të mundshëm, ai lidh çdo aspekt të jetës. Intimiteti shoqërohet me ndjenjën e dashurisë dhe besimit. Ne besojmë se tjetri mendon për më të mirën e interesave tona dhe nuk kemi

frikë se mendimet dhe veprimet tona do të përdoren kundër nesh.

Gruaja dhe burri janë individë që dallojnë nga njëri-tjetri, por që lidhen me njëri-tjetrin nga ana fizike, emocionale dhe frymërore. Ka diçka në brendësi të burrit që thërret për gruan dhe diçka e gruas që dëshiron shoqëri me burrin. Intimiteti seksual është aspekt i bashkimit. Pjesa dërrmuese e çifteve mund të hedhin vështrimin e tyre në të shkuarën, në një periudhë kohe të marrëdhënieve të tyre që quhej "periudha e dashurisë". Atëherë përjetuan një ndjenjë të fortë afërsie. Kur "etapa e dashurisë zhvillohet plotësisht, atëherë kemi një ndjenjë përkatësie ndaj njëri-tjetrit. E ndjejmë se deri diku, ishim bërë për njëri-tjetrin.

E ndjemë në zemrat tona se do ta duam njëri-tjetrin përjetë, se e duam lumturinë e njëri-tjetrit mbi gjithçka tjetër dhe se lumturia jonë varet nga të qëniet me këtë njeri për jetë. Është kjo ndjenjë e thellë e intimitetit që na jep kurajën për t'ia kushtuar jetën tonë martesës. Mund ta fillojmë martesën tonë me një masë të lartë intimiteti, por në një pikë, ne e zvogëlojmë intimitetin

me izolim. Si ndodh kjo humbje e intimitetit? Shumë çifte e përshkruajnë këtë si mur që ngrihet midis tyre.

Si mund të fitohet intimiteti? Përgjigja është e thjeshtë, por jo e lehtë. Muri duhet rrëzuar! Në momentin që ti pranon hapur dështimet e tua në jetë dhe kërkon falje, muri në anën tënde rrëzohet. Nëse bashkshort-i (ja) të fal



dhe për rrjedhojë i pranon gabimet e veta, atëherë muri rrëzohet në të dyja anët dhe intimiteti kthehet pothuaj menjëherë. Askush nuk është i përkryer. Herë pas here e zhgënjejmë njëri-tjetrin, por nëse kemi vullnetin për t'i pranuar dështimet tona dhe për të kërkuar falje, atëherë kemi mundësi ta mbajmë murin të rrëzuar.

Ndërtimi i intimitetit është proces. Procesi me të cilin mbajmë intimitetin, është komunikimi i shëndoshë. Zbulon mendimet, ndjenjat dhe përvojën e vet, ndërsa i pari dëgjon dhe kërkon ta kuptojë. Procesi i thjeshtë i bisedës dhe i dëgjimit mban intimitetin. Ne nuk jemi lexues të mendjes. Vetëm atëherë kur zbulojmë veten para njëri-tjetrit mund të vazhdojmë të ushqejmë ndjenja

intimiteti midis nesh. Pse kjo aftësi njerëzore e thjeshtë, për të biseduar dhe për të dëgjuar bëhet kaq e vështirë brenda martesës? Intimiteti i ka rrënjët në përjetimin së bashku të pasioneve, emocioneve, mendimeve, përvojave,

dëshirave dhe shqetësimeve. Çfarë e pengon rrjedhën e lirë të komunikimit, në një nivel të tillë emocional? Pavarësisht nga arsyeja, disave prej nesh u është mësuar që t'i fshehim apo mohojmë emocionet. Dhimbja e thellë emocionale e përjetuar në fëmijëri, i ka dhënë ngjyrë realitetit të tyre si të rritur. Ndjenjat rrinë të fshehura diku thellë brenda njeriut.

Arsyeja e dytë se përse nuk kemi dëshirë t'i diskutojmë emocionet tona është frika nga reagimi i burrit apo i gruas. Ne kemi frikë se ai ose ajo do të na qortojë për atë që ndjejmë, do të zemërohet dhe do të na kundërshtojë. Arsyeja e tretë është koncepti gabuar se disa emocione nuk janë të pranueshme. Një arsye tjetër që disa individë nuk bisedojnë rreth emocioneve të tyre, është se ata asnjëherë në të shkuarën, nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Një arsye tjetër: "Nuk dua ta ngarkoj burrin apo gruan me përndjekjet e mia emocionale." Një pohim i tillë tingëllon si përkujdesje në sipërfaqje dhe personi ndoshta vërtet kërkon të dijë interesat e partnerit. Kështu ne i mohojmë partnerit mundësinë për të hyrë në intimitet dhe të luftojë bashkë me ne.

Ne nuk u martuam për të gjetur një

mënyrë të përshtatshme gatimi, për të larë enët, rrobat, makinat dhe për të rritur fëmijët. Ne u martuam duke u nisur nga dëshira e thellë për të njohur njëri-tjetrin, për të dashuruar njëri-tjetrin, për ta jetuar jetën së bashku, me besimin se kështu, mund ta përjetonim më thellësisht, sesa veç e veç.

Ne u martuam:

- Që të shprehim mendimet tona.
- Që të diskutojmë ndjenjat tona.
- Që të kalojmë një farë kohe së bashku dhe diskutojmë për kohën që kemi kaluar larg njëri-tjetrit.
- Që t'i hapim zemrën njëri-tjetrit.
- Dhe që trupat tanë bëhen një.

Secili prej nesh jeton brenda mendjes së vet. Edhe nëse jemi në të njëjtën dhomë, ose shumë kilometra larg njëri-tjetrit, mendja jonë vlon nga mendimet. Në qoftë se kërkojmë intimitet, ne duhet të zgjedhim rrugën e shfaqes se këtyre mendimeve ndaj njëri-tjetrit. Është e qartë se ne duhet të përzgjedhim. Mundësia e diskutimit të të gjitha mendimeve është absurde. Jeta nuk është aq e gjatë. Nga ana tjetër nëse nuk i tregojmë njëri-tjetrit asnjë nga mendimet tona, kjo sjell humbjen e intimitetit. Çdo ditë, jeta është e mbushur me ndjenja. Jeta juaj e brendshme është e mbushur me ndjenja dhe askush nuk i sheh ato. Diskutimi i ndjenjave ndërton intimitet emocional.

Të mësuarit për të biseduar rreth emocioneve mund të jetë një nga përvojat më shpërblyese të jetës. Të tilla diskutime kërkojnë atmosferë pranimit.

Diskutimi i ndjenjave pozitive na lejon të hyjmë në gëzimet e njëri-tjetrit. Në të njëjtën mënyrë, edhe kur flasim për ndjenjat negative ne gjithashtu krijojmë intimitet emocional.

Diskutimi i ndjenjave, gëzimeve dhe hidhërimeve, është një nga aspektet më të kënaqshme të martesës. Kur ne i tregojmë emocionet, ne përfshijmë partner-in (en) në një pjesë shumë të fuqishme të jetës sonë. Emocionet pozitive të përjetuara së bashku rrisin gjithë kënaqësinë. Në të njëjtën mënyrë përjetimi i përbashkët i emocioneve negative duhet të sjellë gjithnjë lehtësim dhe mbështetje.

Bashkimi i intimitetit veti me atë të partnerit, është filli me të cilin thurim intimitetin martesor. Është pikërisht

kjo që mendonim se e kishim në fillim, kur u martuam dhe dëshironim ta kishim përjetë. I jep kënaqësi skutave të brëndshme të çiftit dhe në qoftë se ata kanë fëmijë, shërben si model shëmbullor i familjes. Dëshira për intimitet martesor ndikon fuqishëm në të gjitha aspektet e jetës. Së pari ajo ndikon mbi mënyrën e trajtimit të njëri-tjetrit. Më pas, ndikon mbi mënyrën e lidhjes së tyre me fëmijët. Kur intimiteti midis burrit dhe gruas ekziston, rezultatet do të krijojnë një mjedis të shëndetshëm, të favorshëm për rritjen e fëmijëve. Aty ku nuk ekziston, fëmijët do të rriten në një zonë lufte, gjurmët e së cilës mund t'u mbeten për gjithë jetën. Ekziston diçka brenda fëmijës që thotë: "Ja kjo është mënyra si duhej të ishte."

Përgatiti: Valbona Avdullaj

Referenca: "Pesë tregues për një familje të shëndetshme" nga Gary Chapman

Sokrati ka thënë: "Nëse do të shkoja në pikën më të lartë të Athinës, unë do të bërtisja: Ç'kuptim ka të dashur bashkëqytetarë që ju s'lini gurë pa lëvizur për të grumbulluar pasuri, ndërsa kujdeseni kaq pak për fëmijët tuaj, të cilëve, një ditë do t'ua lini të gjitha?" Në pjesën e tretë zbulohet tema: Drejtimi i fëmijëve në mënyrë krijuese.





Pastërtia seksuale në fejesë

Nga Genti dhe Djana Shani

Të dy së bashku si çift kemi pasur privilegjin të bashkërendojmë prej disa vitesh kursin «Të përgatiteni për martesën tuaj», ku pjesë e tij është edhe projekti «Besëlidhja e pastërtisë». Pjesëmarrës në këtë kurs janë kryesisht çiftet e fejuara, që po bëhen gati për të kurorëzuar dashurinë e tyre në një martesë të perëndishme.

Duke marrë shkak nga kjo përvojë, në këtë artikull duam të ndajmë me ju parimet që mësojmë dhe të cilave u besojmë, të ilustruara me mendimet e një çifti, i cili sapo ka përfunduar me sukses rrugëtimin e tij në fejesë, për t'ia dhënë veten tjetrit plotësisht në martesë.

“Ruajtja e pastërtisë seksuale para martesës është si një ndëshkim mizor dhe i pazakontë” – kjo është ajo çfarë na thotë këndvështrimi i botës.

Po jetojmë në kohën e një kulture të çmendur! Interneti, muzika, televizioni, filmat, telenovelat, “reality show” po i inkurajojnë njerëzit të shkojnë deri në fund. Seksi është bërë një fiksion kulturor. Pamja e seksit që pasqyron kultura jonë është një zvetënim i planit fillestar të Perëndisë. Ashtu si thika e një kirurgu, e cila është krijuar për të bërë mirë, por mund të përdoret për të bërë dëm nëse vihet në duar të gabuara, ashtu edhe seksi është shtrembëruar, larg qëllimit fillestar për të cilin u krijuar.

Zoti është ideatori dhe krijuesi i marrëdhënies intime. Por Zoti e krijoi marrëdhënien intime për ta shijuar në martesë. “Për këtë arsye, njeriu do të braktisë babanë dhe nënën e tij dhe do të bashkohet me gruan e tij dhe do të jenë një mish i vetëm”, thotë Zanafilla 2:24.

Ekziston një linjë e përbashkët e të menduarit në kulturën e sotme, sipas së cilës një çift, i cili ka vendosur të martohet, duhet të provojë përputhshmërinë e tij seksuale para se të martohen. Pra, është një lloj mentaliteti “provoje para se ta blesh”! Por nëse përputhshmëria seksuale do të ishte një parakusht për martesën, atëherë natyrshëm Perëndia do ta kishte bërë të qartë në Shkrimin e

Shenjtë. Vetëm ngaqë një person është i aftë për intimitet fizik, jo domosdoshmërisht është i aftë për të mbajtur edhe një martesë të bashkuar. Dashuria është e durueshme dhe një çift që është i sigurt në dashurinë e vet, e di që do të ketë gjithë pjesën tjetër të jetës së vet për ta shijuar seksin.

Pse është e rëndësishme pastërtia seksuale në fejesë?

Kjo ishte pyetja që i bëmë çiftit të ri, të sapomartuar, dhe ja si u përgjigjën: “Së pari, shmanget ndjesia e fajit përpara Perëndisë. Në fillim të martesës duhet të përshtatemi dhe ka raste kur ende duket si ndjenjë faji derisa të mësohesh. Imagjino si do të ndiheshim nëse do të ishte jashtë kontekstit martesor. Ndjenja e fajit do të na rëndonte shpirtin.

Së dyti, pasiguritë dhe problemet në çift çojnë shpesh në mendime se nuk jemi për njëri-tjetrin. Nëse do të ndaheshim dhe jemi të përfshirë në marrëdhënie seksuale, atëherë kjo do të linte njollë në emocionet dhe trupat tanë.

Së treti, ne nuk lëmë asgjë të re për martesën, sepse çdo gjë është konsumuar më parë.”

Perëndia kishte më të mirën në

mendje për ne kur Ai na dha porosi të forta lidhur me pastërtinë seksuale para martesës. “Martesa të nderohet nga të gjithë dhe shtrati martesor i papërlyer, sepse Perëndia do të gjykojë kurvarët dhe kurorëshkelësit.” (Hebrenjve 13:4)

Pastërti seksuale do të thotë më shumë sesa të mos kryesh marrëdhënie seksuale para martesës. Shumë çiftet e shmangin marrëdhënien, por, megjithatë, kanë intimitet seksual. Bibla na e sugjeron pastërtinë seksuale si “mënyrën për të qenë të shkëlqyer nga ana morale” dhe shkëlqim moral do të thotë të jesh i/e shenjtë. Do të thotë, pastërti në mendje, si edhe pastërti në vepra. Do të thotë të mbrojmë pafajësinë e njëri-tjetrit, për të mos u njollësuar nga ligësia. “Prandaj unë përpigem vazhdimisht të kem një ndërgjegje të paqortueshme përpara Perëndisë dhe përpara njerëzve.” (Veprat 24:16.)

Po jua paraqesim në mënyrë të përmbledhur përfitimet që kemi nga pastërtia në fejesë:

- Ju kënaqni Perëndinë.
- Ju jeni të mbrojtur nga trauma emocionale, mendore dhe fizike, nëse do t’ju duhet të ndërprisni marrëdhënien përpara martesës.
- Ju ndiheni të lirë për ta njohur personin tjetër ashtu siç përcaktoi Perëndia për ta njohur para martesës. Çiftet të cilat kanë marrëdhënie intime gjatë fejesës, e humbin atë aftësi për të parë më thellë në marrëdhënie, në të kaluarën e tyre, në të tashmen dhe në të ardhmen. Marrëdhënia seksuale mund t’i verbojë ata kaq shumë, sa të mos kuptojnë që marrëdhënies së tyre i mungon intimiteti i vërtetë.

Si mund ta ruajmë njëri-tjetrin nga tundimet?

Me të drejtë, mund të pyesim: Po ne na kanë mbetur vetëm disa javë nga dita e martesës. Pse të mos fillojmë ta provojmë që tani atë çka na është premtuar në martesë?

Ky lloj të menduari është i gabuar. Në këtë rast, duhet të vazhdojmë të presim me besim, me një besim të shenjtë, derisa formalizimi i lidhjes të vijë. Do të ishte e vështirë të dallojmë pikën ku fillon vërtet “formalizimi” e ku fillon “përshtypja sikur gjithçka është formalizuar”. Të fejuarit duhet të mësojnë të

presin nga njëri-tjetri dhe t’i besojnë njëri-tjetrit.

Më poshtë vijojnë disa hapa që ndihmojnë për të pritur në këtë fazë:

1. Lutuni individualisht dhe së bashku.

Ne e dimë se nuk mund të fitojmë vetë asnjë betejë, por kemi nevojë për Zotin. Ndaj lutja do të na ndihmojë për të qëndruar të fortë.

2. Vendosni kufij në marrëdhënien tuaj.

Çifti ynë i sapomartuar na tregon për kufijtë që kishin vendosur gjatë periudhës së fejesës:

- Ne do t’i shmangim prekjet fizike apo përkëdheljet në vende të ndjeshme, të cilat do të shkaktonin epsh dhe dëshirë për intimitet fizik.
- Nuk do të rrimë vetëm në orët e vona të natës.
- Do t’i shmangim vendet e errëta dhe të vetmuara, sidomos në shtëpi.

3. Krijoni një marrëdhënie përgjegjshmërie.

Zgjidhni një person tek i cili keni besim, që mund të jetë një shok ose një mentor, dhe ndani me të tundimet dhe përjetimet tuaja.

Cili është standardi juaj? Sa larg shkon vija juaj e kufirit? Cili do të jetë standardi juaj në lidhje me pastërtinë seksuale? Me ndihmën e Zotit mund të përballojmë çdo tundim. (1 Korintasve 10:13) Ai gjithmonë na jep një rrugëdalje, ndërsa ne zgjedhim.

Si mund t’i japim zemër njëri-tjetrit për të qëndruar dhe pritur deri në fund?

Një shqetësim që vjen kryesisht nga vajzat është presioni nga të fejuarit për të pasur një marrëdhënie intime gjatë fejesës. Ky presion është një shenjë mosrespekti, një mungesë udhëheqjeje shpirtërore, një mungesë respekti për njeriun e brendshëm. Martesa është e vështirë dhe nëse që tani nuk keni një respekt të ndërsjellë dhe një harmoni shpirtërore, në martesë shenjat do të jenë më alarmante. Çifti që intervistuar na tregoi disa prej vendimeve që kanë marrë së bashku për të pritur deri në fund:

Në bindje ndaj urdhërimit të Perëndisë, unë premtoj të mbrojmë pastërtinë tënde seksuale që nga kjo ditë deri në muajin tonë të mjalitit. Ky është premtimi im i pastërtisë.

Nënshkruar

“Ne vendosëm një pakt me njëri-tjetrin se nuk do ta shkelnim urdhrin e Zotit. Mësuam vargje përmendsh. Lexuam libra rreth fushës.”

Përmes këtyre mendimeve po ju sugjerojmë një besëlidhje pastërtie që nënshkruhet midis të dy partnerëve, për të ndihmuar njëri-tjetrin të mbrohen deri në martesë. “Sepse ky është vullneti i Perëndisë: shenjtërimi juaj; të hiqni dorë nga kurvëria; që secili prej jush të dijë ta mbajë enën e vet me shenjtëri dhe me nder, jo me pasione epshi...” (1 Thesalonikasve 4:3-8)

Shumë nga ata që janë duke e lexuar këtë artikull sot e dinë se çfarë është e drejtë. Disa kanë nevojë të pendohen, të tjerë, që kanë dështuar dhe janë penduar, kanë vendosur disa standarde më të larta. Të gjithë duhet të kthehemi tek Shkrimi dhe të kuptojmë se Jezu Krishti na ka falur. 1 Gjonit 1:9 thotë se “nëse i rrëfejmë mëkatet tona, Ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi.”

Duke pasur parasysh se sa sfidues mund të ketë qenë ky artikull, ne gjithmonë duam të shpallim se kur terrenin tonë e lëmë në këmbët e Jezusit, Ai di ta sheshojë atë gjithnjë.

Nëse qëndroni në premtimet e Krishtit, atëherë do të përjetoni bollëkun e Tij, edhe nëse të tjerët në botë rreth e rrotull jush, do të jenë mosbesues kur të dëgjojnë për standardet tuaja të pastërtisë.

Përgatitën dhe shkruan
Genti dhe Djana Shani
JetëFamiljare
jetefamjare@albaniacc.org
familja@jetefamiljare.org
www.jetefamiljare.org



Komunikimi në familje

Disa ide për komunikimin në familje

Fëmijët kanë mendje shumë aktive dhe veshi iu kap shumë gjëra për të cilat flasin të rriturit. Ata mund të mos i kuptojnë të gjitha gjërat që dëgjojnë, por krijojnë domethënie dhe situata për të shpjeguar gjërat që ndodhin në jetët e tyre.

Një mikja ime, ishte vetëm pesë vjeçe, kur mësoi se çfarë ishte poliomieliti. Mësoi që ishte një sëmundje e tmerrshme që mund ta marrësh nga njerëzit e tjerë dhe që të shkakton paralizën e gjymtyrëve, aq sa të mos jesh në gjendje të ecësh. Jo shumë kohë pasi e mësoi këtë, dëgjoji që një burrë, një polic ishte duke ardhur te shtëpia e tyre. Në momentin që ajo dëgjoji “polic”, në veshët dhe mendjen e saj ajo dëgjoji ‘poliomielit’, kështu që në mënyrën se si e kuptonte, një burrë po vinte në familjen e saj për t’iu dhënë atyre poliomielin. Kur burri erdhi, ajo u mërzit aq shumë, saqë jo vetëm që nuk foli, as përshëndeti,

por shkoi drejt e tek ai dhe e gjuajti me shkelm. Prindërit i bërtitën dhe ajo mori edhe një shpullë të mirë. Ndërkohë që babai i saj po fliste me të, me lot në sy, tha me nxitim: “Por pse e lejove atë të hynte brenda, ai do të na e ngjitë poliomielin, a nuk e di se çfarë është?” Prindërit e saj më në fund e kuptuan gabimin dhe me dashuri i shpjeguan asaj çfarë ishte një polic sigurimi.

Mua më kujtohet, që fjalët mekanik dhe maniak, ishin ngatërruar në mendjen time e kështu mendoja që në një servis makinash kishin punësuar “një maniak” në punë, në vend të një mekaniku për të riparuar makinat.

Si rezultat i keqkuptimit, fëmijët mund të kenë shumë frikëra dhe nuk e dinë kë apo kur mund të pyesin për t’u sqaruar.

Është e rëndësishme të kesh një kohë mënjane për të komunikuar me fëmijët! Gjithashtu është e rëndësishme të kesh kohë me secilin

fëmijë një nga një, çdo ditë!

Qoftë edhe një kohë të shkurtër prej 10 minutash, mund të jetë një ndihmë. Kjo është një kohë ku ju bashkëveproni me një fëmijë. Përpiquni që të mos ketë ndërprerje. Është mirë që të dy prindërit, të kenë një kohë të tillë. Gjithashtu ora e gjumit është një kohë e mirë për t’i pyetur fëmijët për ditën e tyre, apo edhe nëse ata kanë ndonjë pyetje për diçka që mund të ketë ndodhur gjatë ditës. Përgjigjuni dhe shpjegoni çdo pyetje me kujdes. Asnjëherë mos u shfaqni shumë i tronditur, i mërzitur apo i mbytur në lot, sepse emocionet e tepërta mund t’i alarmojnë fëmijët dhe mund ta shuajnë komunikimin e mëtejshëm.

Një baba ishte duke e vënë në gjumë djalin e tij; ata jetojnë në Afrikë dhe shërbejnë si misionarë atje. Djali i tij po i tregonte për ditën interesante që kishte pasur duke luajtur jashtë. I tregoi që kishte gjetur një gjarpër afër garazhit, por që babai nuk duhej

të shqetësohej aspak për këtë, sepse ai i kishte hedhur gurë dhe e kishte plagosur. Pastaj i ishte afruar, e kishte kapur gjarpërin dhe kishte lidhur një nyje në të. Meqë djali i tij e dinte që gjarpërinjtë ishin të ligj dhe mund t'ju bëjnë keq njerëzve e ai nuk do të dëshironte që ai të ngrihej dhe t'i bënte keq askujt.

Brenda vetes i ati ishte i lemerisur, sepse e dinte që kishte shumë gjarpërinj helmues në atë zonë dhe një gjarpër i trullësuar mund të vinte në vete shumë shpejt. Ai kishte dëgjuar për gjarpërinj që ishin rrahur me shkop dhe më vonë e kishin rimarrë veten dhe kishin ikur duke u zvarritur. Pa e humbur qetësinë ai e pyeti të birin, ku e kishte lënë gjarpërin, dhe nëse mund t'ia tregonte të atit ku ishte. Të dy u ngritën dhe ecën pas garazhit dhe aty e gjetën të ngordhur mbretin helmues kobra, me një nyje në mes!

Ruani qetësinë kur dëgjoni!

Në qoftë se babai në këtë rast do ta kishte shfaqur frikën e tij, i biri mund të mos ia kishte treguar të tërë historinë.

Kur djali ynë filloi të shkonte për herë të parë në kopshtin e fëmijëve në afërsi të shkollës publike, e gjithë atmosfera e kaq shumë fëmijëve në të njëjtin vend, dhe pritja për t'u sjellë mirë ishin krejtësisht të reja për të. Ai ishte një fëmijë i ndjeshëm dhe dëshironte të bënte gjënë e duhur. Pasi vinte nga shkolla, ulej dhe ndiqte në TV programin e tij të preferuar, i cili fatëqësisht përmbante një farë dhune. Ndërkohë që ishte i ulur, ai vërtiste ca fije floku nëpër gishta dhe pastaj i shkulte. Pa kaluar shumë kohë, ai kishte zhveshur një pjesë të madhe në majë të kokës, duke e bërë tullac. Pastaj ne kërkuam ndihmën e një mikeje, e cila ishte punonjëse sociale. Për fat të keq, nuk ka shumë burime ku prindërit të drejtohen

për ndihmë, por fatmirësisht ishte një grup në zonën tonë. Ajo sugjeroi që ne të merrnim pjesë në klasat e prindërimit, gjë që e bëmë. Këto klasa na hapën sytë. Fokusi kryesor, ishte se si të komunikim me fëmijët dhe si të krijojmë një lidhje të ngushtë me ta.

Përmirësoje atmosferën në shtëpi, në mënyrë që shtëpia të jetë një vend i sigurt për komunikimin!

Një mjet komunikimi janë takimet familjare. Kjo mund të ndodhë formalisht ose jo formalisht.

Të caktosh një takim familjar në mënyrë formale është të caktosh një kohë, kur e gjithë familja mbledhet së bashku, ku merren shënime dhe udhëheqja bëhet me radhë.

Përmirësoje atmosferën në shtëpi, në mënyrë që shtëpia të jetë një vend i sigurt për komunikimin!

Takimet familjare jo formale, janë mbledhja për një kafe në kohë të ndryshme dhe komunikimi si një familje.

Familja jonë organizonte takime formale. Ishte një kohë e mrekullueshme dhe tani kur kthej kokën pas, kujtoj me dashuri kohët kur ne uleshim rreth tryezës dhe dëgjonim zërat e fëmijëve tanë.

Udhëheqja e takimeve bëhet me radhë dhe gjithashtu mbajtja e shënimeve. Më kujtohet tek shikoja ato duar të vogla që mbanin shënime dhe shlyenin. Gjithmonë thekso që fëmijët të jenë krejtësisht të hapur e të thonë çdo gjë, në takimet familjare. Gjërat për të cilat fëmijët tanë diskutonin ishin për shembull, që dy dollarë nuk ishin mjaft, për para xhepi për një javë.

Gjithashtu, kjo është një kohë e mirë

për të planifikuar kohën e pushimeve dhe kohë të tjera me familjen, të diskutosh punët e familjes, të vendosësh rregullat e disiplinës. Përpiquni të arrini një marrëveshje për vendin që do të zgjidhni për pushimet, por nëse nuk arrini në një marrëveshje, (ka plot gjëra, për të cilat nuk janë të gjithë në të njëjtën mendje), babai le të jetë ai që do ta caktojë vendin.

Ne e quanim shtëpinë tonë një shtëpi për njerëz që nuk fshihen, gjithashtu, një vend pa emra. Kjo do të thoshte që ne nuk do t'i thërrisnim kurrë njëri-tjetrit me emra negative si; budalla, i trashë, ose fjalë të tjera ofenduese, dhe njerëzit që godisnin njëri-tjetrin kishin pasoja serioze.

Gjithmonë, lutuni me fëmijët, para se ata të flenë.

Kur fëmijët tanë ishin të vegjël ne luteshim së bashku pranë krevateve të tyre. Kur u bënë adoleshentë, uleshim në dhomën e ndenjies dhe lexonim Biblën së bashku; ndanim kërkesat e lutjes dhe luteshim. Çdo mik që vinte në shtëpi duhej të merrte pjesë, edhe nëse ishin jobsimtarë.


Sara, ishte një nga shoqet e Melit. Ajo do të vinte tek ne një pasdite dhe do të ishte atje në kohën tonë të zakonshme të lutjes. E dinim që ajo nuk ishte besimtare dhe që babai i saj ishte mysliman. Gjithsesi ne ndjemë që duhet të vazhdonim praktikën e familjes, por asaj nuk do t'i kërkohej që të lutej. Në fakt ajo mori pjesë madje edhe u lut. Pastaj e pyeti vajzën tonë, "E bën familja jote çdo natë këtë takim lutjesh?"

Më vonë ajo e pranoi Krishtin. Kur u pyet se çfarë e kishte ndikuar atë, ajo tha, "Kontakti që pata me familjet e krishtera të miqve të mi."

Nga Sindi Helvi

Çfarë duan femrat

Pjesa e dytë



Të dashur miq dhe lexues të revistës “Ilira”,

Sa herë që bëhem gati për të shkruar një shkrim të ri, bisedoj më parë me njerëz të ndryshëm dhe kërkoj edhe opinionin e tyre në lidhje me temën e përzgjedhur. Të njëjtën gjë bëra edhe këtë javë dhe u mahnita nga larmia e përgjigjeve të dhëna. Njëra syresh qe e tillë: “Femrat duan /rr/ të fortë tek fjala burrë”. Këmbëngula në shpjegimin e kësaj përgjigjeje të dhënë nga një zonjë dhe ajo më shpjegoi që rr-ja e fortë për të nënkuptonte: kujdes, dashuri, liri, mirëkuptim, durim për ta dëgjuar, siguri etj.

90% e femrave të intervistuar flasin për të njëjtën nevojë: për bashkëbisedim me bashkëshortët e tyre. Në fakt dëshiroj që t’ju bëj një pyetje edhe juve që po e lexoni këtë shkrim. A e mbani mend se sa gjatë bisedonit me të dashurin/të dashurën në kohën e njohjes? Në të vërtetë, sidomos gjatë periudhës së njohjes një çift nuk resht së foluri. Bisedat janë të gjata, plot intensitet e larmi dhe të mbushura me kërshtëri e me një dëshirë për të hapur tema interesante.

Fatkeqësisht, rëndom ndodh që pas martese cilësia e bashkëbisedimit bie ndjeshëm, pasi çifti ka konsumuar kaq shumë biseda, dhe bien në një gjendje “gjumi”, ku secili përfshihet në gjëra të cilat u marrin kohën dhe vëmendjen. Bashkëshorti vjen nga puna i lodhur dhe mendon të ulet e të shohë lajmet apo të lexojë gazetën sportive me dëshirën për t’u çlodhur. Gruaja, nga ana e saj, mezi pret që bashkëshorti të kthehet nga puna e të bisedojë me të sesa të bukura qenë këpucët e nuses së kushëritit të saj të dytë, e cila ka hapur një dyqan shumë të bukur në qytet.

Ai: i lodhur nga bisedat e ditës në

punë pret që të bjerë rehat në shtëpi, duke mos folur e duke mos iu përgjigjur askujt. Nuk ka asgjë kundër së shtrenjtës së tij, por ja që nuk i flitet më.

Ajo: dëshiron që t'i tregojë atij çdo detaj, qoftë edhe të parëndësishëm, qoftë edhe thjesht sa për të biseduar, pasi ajo ka nevojë që të flasë me dikë. Përse ai nuk ka dëshirë që të flasë më me të? Ai fliste dikur, madje për lloj-lloj gjërash.

Bisedat e një femre vërtiten rreth ngjarjeve të ditës së saj, rreth njerëzve që ajo ka takuar, rreth ndjesive që ata i kanë shkaktuar. Ajo ka nevojë që dikush tjetër të jetë pranë saj, jo vetëm për ta dëgjuar, por edhe për ta shoqëruar në ndjesitë e saj. Kur kjo gjë ndodh, ajo ndihet shumë mirë dhe e afërt me atë person.

Kur bashkëshortët nuk janë "veshi i hapur" për të bashkëbiseduar, femrat ndihen keq. Sidomos kur ata heshtin me ty dhe "iu zgjidhet gjuha" me miqtë e tyre, duke bërë biseda nga më boshet (sipas mendimit tënd).

Nëse një çift dëshiron që ta mbajë marrëdhënien apo martesën të shëndetshme, duhet të mendojë me shumë kujdes për përmbushjen e nevojave të njëri-tjetrit. Nuk mund të bisedosh nëse nuk ke kohë për bisedë.

Tregohuni të kujdesshëm që çdo ditë të keni një sasi kohe të mjaftueshme për të bashkëbiseduar rreth punës, ndjesive, sfidave, shqetësimeve apo edhe ndaj gjërave që juve ju duken të parëndësishme, por që e dini shumë mirë se janë të rëndësishme për bashkëshorten tuaj.

Grave iu pëlqen shumë që gjatë ditës të marrin ndonjë telefonatë apo ndonjë mesazh prej jush. Mos ua privoni këtë kënaqësi!

Folëm në fillim të këtij shkrimi se si gjatë periudhës së njohjes një çift shijon biseda të mrekullueshme. Po ta mbani mend, gjithsekush nga ne ka pasur dëshirë për ta njohur tjetrin sa më mirë dhe për t'i rrëfyer se sa shumë kujdesemi për të. Kini kujdes që të mos e humbisni këtë ndjesi, pasi një marrëdhënie dashurie duhet mbajtur në jetë, ajo nuk mbetet e njëjta pa treguar kujdes për të.

Burrat, duke anashkaluar këtë nevojë të rëndësishme të grave, u japin atyre mesazhe të gabuara, si: mosintere-

simi, indiferenca apo edhe mungesa e dashurisë.

Shumë raste të tradhtive bashkëshortore kanë filluar thjesht sepse gruaje ka gjetur dikë i cili e dëgjon atë me ëndje apo edhe bisedon me të, krejt ndryshe nga burri i saj, i cili i ka mbaruar të gjitha temat e bisedave me të.

Pa bashkëbisedim të përditshëm 'nuk mund të mbahet në këmbë' një marrëdhënie e ngrohtë dashurie dhe një marrëdhënie intime e shëndetshme, për të cilat kanë nevojë partnerët.

Ekzistojnë disa "përbindësja" të cilët e "mbysin" bashkëbisedimin në çift:

1. Kryerja e bisedave për të ndëshkuar tjetrin. Ka çifte që gjatë një bisede përdorin nofka për t'iu drejtuar njëri-tjetrit. Nuk dihet se nga ku nxjerrin epitete fyese dhe i kundërvihen çdo gjëje të mirë që kanë së bashku.

2. Biseda ku tjetrit i imponohet një opinion me çdo kusht. Këto janë biseda shumë të pakëndshme, ku palët nuk kuptohen, sepse njëri nuk arrin të kuptojë mendimin e tjetrit, duke kërkuar që tjetri të bjerë dakord, qoftë edhe kundër dëshirës së vet.

3. Përsëritja e gabimeve të së shkuarës, duke kujtuar episode të pakëndshme dhe dështime në çaste të vështira, duke tallur e duke ulur njeriun e shtrenjtë e të dashur, për të cilin je betuar se do t'i qëndrosh pranë deri në vdekje.

Për çfarë mund të bisedoni me njëri-tjetrin?

Për gjëra nga më të ndryshmet, duke filluar që nga ditët tejet të nxehta e deri tek Xhokoviçi, kampioni më i ri i tenisit për meshkuj, nga kriza ekonomike greke deri tek ngjyrat që janë në modë në këtë sezon, nga dhëmbët e parë të foshnjës suaj deri tek tensioni i tezes nga babai. Mos kini drojë të bisedoni për sfidat dhe frikërat tuaja. Femrat ndiejnë shumë siguri kur flasin për gjërat sfiduese me bashkëshortët e tyre. Shpeshherë unë i kërkoj mendim bashkëshortit tim të duruar edhe për detaje që për meshkujt nuk kanë kurrfarë rëndësie, por ideja që ai më ka dëgjuar, më bën me krahë dhe ma lehtëson vendimmarrjen.

Indiferenca dhe mungesa e komunikimit çon drejt thellimit të hapësirave ndarëse dhe femrat bëhen të ashpra dhe

Nëse një çift dëshiron që ta mbajë marrëdhënien apo martesën të shëndetshme, duhet të mendojë me shumë kujdes për përmbushjen e nevojave të njëri-tjetrit.



cinike shumë lehtë, ndërsa meshkujt të pandjeshëm.

Uroj që të keni dëshirë për të përmbushur nevojat e njëri-tjetrit me një zemër të dashur, përulësi e mirësi!

Ndërsa ju jetoni jetën tuaj në çift, nëse keni fëmijë, ju po modeloni edhe një rol të rëndësishëm përpara tyre. Kujdes se çfarë modeloni!



Dashamirësisht,
Edi Gogu
Lëvizja
"PROFAMILJA"

"Aman dhe ti si je! A nuk ta thashë unë? Sikur ta dija që do të ndodhte kështu të shkretën!"

Fjali plot tension e të mbarsura me inat, që të gjithë i urrejnë t'i dëgjojnë: që nga fëmijët e vegjël, të rriturit e sidomos bashkëshortët, e kjo për faktin se këta njerëz kanë marrëdhënie tepër të ngushta me njëri-tjetrin.

Këto fjalë të sëmbojnë shpirtin dhe japin sinjalin se personi që sapo i ka nxjerrë nga goja ato fjalë ka grumbulluar pakënaqësi, gjykim dhe akuzë në zemrën e vet kundrejt personit të cilit po ia hedh ato qortime.

Çdo ditë ne ndërveprojmë me njëri-tjetrin dhe marrim një numër të madh vendimesh si individë, si bashkëshortë, si prindër. Çfarë ndodh në rastet kur për vendime të rëndësishme ju dhe bashkëshorti/ja juaj nuk keni të njëjtin mendim? Si reagoni kur jeni të acaruar keq me njëri-tjetrin? A pasqyron qëndrimi dhe reagimi juaj karakterin e një burri apo gruaje të perëndishme, ku Krishti është qendra e martesës?

Kol 3:18—*Ju bashkëshorte, jini të nënshtruara bashkëshortëve tuaj, ashtu si ka hije në Zotin. 19—Ju bashkëshortë, duajini bashkëshortet tuaja dhe mos u bëni të ashpër ndaj tyre. 24—duke ditur se nga Zoti do të merrni shpërblimin e trashëgimisë, sepse ju i shërbeni Krishtit, Zotit.*

Duke qenë të rinj në besim, pa pasur një traditë të trashëguar të shembujve të martesave, ku Krishti është qendra e martesave dhe familjeve tona, shumë herë ne reagojmë dhe veprojmë sipas shembujve të huazuar nga librat, apo më keq, nga çfarë na ofron televizioni. Më e bukura është që gjithçka që media na ofron është shumë larg asaj që na mëson Bibla, që të jemi të nënshtruara, të dashura, mbështetëse të bashkëshortëve tanë, pasi duke i bërë të gjitha këto, nderojmë Krishtin. Perëndia na ka thirrur për të jetuar sipas një standardi më të lartë sesa ai që shfaqet në televi-



SI T'INDEROJMË BASHKËSHORTËT NË SY TË FËMIJËVE

zion, në median e shkruar, në tavolinat e kafeneve të panumërta, në lidhje me marrëdhëniet bashkëshortore.

Shpeshherë na ndodh që vargjet e dhëna mbi nënshtrimin i lexojmë: "Ah po, ja, edhe ca urdhra të tjera për gratë e shkreta, burrat janë rehat". Në fakt e anashkalojmë që të lexojmë pakëz më tutje thirrjen që Perëndia u bën burrave "duajini gratë tuaja!"

Kur isha vajzë e pamartuar, i kuptoja krejt ndryshe vargjet e mësipërme. Ndërsa vitet rrodhën dhe bashkë me martesën erdhën edhe fëmijët, kuptova që Perëndia kishte "fshehur" shumë urtësi në këto urdhërime. Këtë gjë vazhdoj ta kuptoj edhe tani, sidomos nëpër diskutimet që ne bëjmë mes shoqeve.

Por si mund të tregojmë respekt dhe nënshtrim ndaj bashkëshortëve tanë në ato raste kur ne nuk biem dakord në çështje të mëdha, siç janë: shëndeti,

ushqyerja, stili i jetesës, vendimi se ku do të jetojmë, si dhe ku do t'i shkollojmë fëmijët tanë, si do t'i administrojmë të ardhurat familjare etj.?

Nënshtrim nuk do të thotë shtypje, megjithëse termi "nënshtrim" (lexo: shtypje) për lëvizjen feministe në vitet 1950 nënkuptonte shtypje. Perëndia ynë, Krijuesi i gjithçkaje, nuk ka dashur kurrë që tek gruaja të shpalesë tiparet e një krijese të "humbur". Ai na ka pajisur ne me disa aftësi për të cilat bashkëshortët tanë kanë nevojë dhe i ndihmojnë ata për të marrë vendimet e duhura, duke i dhënë lavdi Perëndisë në çdo gjë.

Nënshtrimi vjen butësisht, pasi nënkupton që ti heq dorë nga diçka në çastin që kupton që, nëse dëshiron që të ecësh përpara në jetën në çift, dikush duhet të heqë dorë nga e vetja. Kjo nuk do të thotë që idetë dhe mendimet e

tua janë të pavlefshme, por që ti nuk po kërkon merita. Kjo është ajo çka bashkëshortët ndiejnë shumë herë kur ndodh një mosmarrëveshje mes tyre, pasi gjatë zënkave ata pozicionohen si armiq mes tyre, duke u përpjekur që të vërtetojnë argumentet e tyre. Në çastin që mes bashkëshortëve gjendet zgjidhja, atëherë mes tyre fillon të sundojë një situatë çlirimi.

Nëse ne e vlerësojmë këtë ndjesi paqeje dhe çlirimi që vjen prej Zotit, duke e pasur parasysh këtë fakt, nënshtrimi (që jo gjithmonë arrihet lehtësisht i arrihur) bëhet më i lehtë.

Nuk duhet të harrojmë që në çdo situatë të këndshme apo të pakëndshme (nëse çifti ka fëmijë) veprimet, fjalët dhe reagimet apo qëndrimet tona janë një Bibël lehtësisht e lexueshme për fëmijët tanë.

Si e trajtojmë ne njëri-tjetrin kur jemi vetëm? Po në prani të fëmijëve tanë? Si e "etiketojmë" ne njëri-tjetrin?

Një nga nevojat më të mëdha të një mashkulli është nevoja për t'u ndier i respektuar dhe shumë herë ne nuk e kuptojmë këtë gjë, duke menduar se dashuria që ne i japim është gjithçka për të cilën ai ka nevojë. Ndaj edhe me veprimet tona, me dashje apo pa dashje, ne nuk i shprehim respektin dhe besimin që kemi tek ai.

Një nga mënyrat për të shprehur respektin ndaj bashkëshortit është nënshtrimi, megjithëse është diçka e cila nuk vjen në mënyrë të lehtë. Por ju plot respekt mund të thoni "Besoj tek urtësia jote", ose "Unë mendoj ndryshe, por kam besim tek ti dhe do të të mbështes në vendimin tënd". Kjo do të thotë shumë për bashkëshortin tënd dhe për fëmijët tuaj. Ata do të shohin një nënë që respekton babanë e tyre edhe kur ajo mendon ndryshe prej tij. Do të shohin se si ajo shtron shembullin e një gruaje të perëndishme përpara bashkëshortit dhe fëmijëve të saj.

Nëse jeni nënshtruar, atëherë vazhdoni të jeni e tillë deri në fund, edhe kur gjërat nuk shkojnë ashtu siç e prisni dhe mos përdorni thënien e shpeshtë "A nuk të thashë unë?" Nëse ratë dakord me mendimin e tij, çdo reagim apo koment tregon që ju nuk e keni pasur me gjithë mend nënshtrimin tuaj.

Nëse ju e trajtoni bashkëshortin tuaj si të paaftë e të paarsyeshëm, çfarë do

të mendojnë fëmijët tuaj për të? Si do të ndihen ata për babanë e tyre? Si do të sillen ata me babanë e tyre?

Krijimi i besimit tek bashkëshorti juaj dhe krijimi i besimit të fëmijëve tek babai i tyre janë ndër gjërat e rëndësishme në jetën e një familjeje, sidomos kur flasim për familjet e krishtera.

Një kujtesë e mirë për ne është vargu i 1 Pjet. 3:1 "Gjithashtu edhe ju, gra, nënshtroni burrave tuaj, që, edhe nëse disa, nuk i binden fjalës, të fitohen pa fjalë, nga sjellja e grave të tyre".

Zakonisht në familjet shqiptare nënat kanë mundësi që të kalojnë më shumë kohë pranë fëmijëve të tyre. Duke qenë se ne jemi ato që u mësojmë gjuhën e folur (gjuha e mëmës) fëmijëve tanë, i mësojmë të ecin, të njohin botën përreth, u mësojmë Fjalën e Zotit (ne i prezantojmë fëmijët me heronjtë biblikë, me historitë e mrekullueshme të Biblës), i mësojmë të luajnë, të njohin e të shprehin veten e tyre, i mësojmë gjithashtu edhe për virtytet e cilësitë e baballarëve të tyre. Jemi ne ato që u rrëfejme fëmijëve tanë për pjesë të karakterit të baballarëve të tyre, që ata si fëmijë nuk i kuptojnë dhe nuk dinë t'i dallojnë dot ende.

Nëse ne flasim keq pas krahëve të bashkëshortëve tanë për dobësitë e tyre mes mikeshash apo me të afërmit tanë, çdo gjë që kemi "predikuar" në sy të fëmijëve, bie poshtë.

Fëmijët përçojnë mënyrën se si ne u drejtohem bashkëshortëve tanë në çdo situatë. Ata shohin tek ne shembujt e heronjve që duan apo nuk duan të ndjekin gjatë jetës së tyre. Nëse unë

si nënë nëpërkëmb babanë e fëmijëve të mi, atëherë edhe vajza ime do të mësojë që të bëjë të njëjtën gjë me vëllezërit e saj, me bashkëshortin e saj në të ardhmen dhe me djalin e saj.

Gjithashtu edhe djemtë e mi do të mësohen me nëpërkëmbjen dhe mungesën e respektit që unë shfaq ndaj babait të tyre dhe ata do të mësohen të pranojnë mungesën e respektit nga gratë e tyre në të ardhmen.

Sikundër Krishti është kreu i kishës, ashtu edhe burri është kreu i familjes dhe këtë nuk e them unë, por na e mëson Fjala e Zotit tonë.

Marrëdhënia jonë si bashkëshortë reflekton imazhin e Perëndisë, ndaj duhet ta trajtojmë e respektojmë njëri-tjetrin si krijesa të çmuara, të krijuara sipas shëmbëlltyrës së vetë Krijuesit.

Unë nuk jam një grua e përsosur, as bashkëshorte apo nënë e përsosur, por dëshiroj që fëmijët e mi ta shohin dhe ta respektojnë babain e tyre si kreun dhe autoritetin e familjes sonë. Ai është autoriteti ynë frymëror dhe vizionari i familjes sonë. Ai ka përgjegjësi përpara Perëndisë për jetët tona frymërore. Detyra ime si ndihmëse e tij është që ta mbështes, të lutem dhe t'i jap këshilla sipas urtësisë së Zotit në rastet kur ai ma kërkon një gjë të tillë.

Ju uroj urtësi prej së Larti dhe Zoti i dritave ju udhëheqtë në çdo hap!

Përzemërsisht,

Edi Gogu

Drejtuese e lëvizjes "PROFAMILJA"
Profamilja.wordpress.com



Intimiteti në martesë

Duke njohur veten, duke të njohur ty

Shumë njerëz sot përballen me një krizë për të cilën ata patjetër që do të pendohen në marrëdhëniet e ardhshme. Kriza është ajo e intimitetit. Sjellja e rastësishme në lidhje me intimitetin dëshmon se ekziston një pështjellim në lidhje me atë që është sjellje normale në një marrëdhënie. Kur dikush luan me këto ndjenja dhe ka një qëndrim të shkujdesur ndaj intimitetit, ai priret të rritet pa pasur një kuptim të vërtetë për intimitetin. Dëshiroj të shohim së bashku se çfarë do të thotë intimiteti në një martesë.

Kjo është një temë që shpesh shmanget, për shkak se është kaq vetjake. Po ashtu është një temë e cila shumë shpesh është keqkuptuar. Intimiteti në një martesë! Dua t'i drejtojmë mendimet tona për të marrë parasysh tri gjëra: (a) Çfarë nuk është intimiteti? (b) Çfarë është intimiteti? (c) Si mund të rritemi në intimitetin martesor? E gjitha kjo bazohet në parime biblike për intimitetin në martesë.

Çfarë nuk është intimiteti

Në kundërshtim me mesazhin e botës dhe të kohës në të cilën jetojmë, intimiteti nuk është thjesht marrëdhënia seksuale. Po, marrëdhënia seksuale është dhënë nga Perëndia dhe është një pjesë e bukur e marrëdhënies martesore, por intimiteti shkon shumë më thellë. Nëse është vetëm aspekti fizik, do të thotë që është thjesht plotësimi i një dëshire/nevoje fizike ose, në shumë raste, plotësimi i epshit. Intimiteti nuk vjen vetvetiu kur martohesh. Besoj se ka shumë çifte që janë të bllokuar në një martesë ku mungon intimiteti i vërtetë dhe ku dashuria nuk është e pranishme. Ka mundësi të martohesh e, megjithatë, të bësh një jetë shumë të vetmuar pa pasur asnjë person që të njeh, të do dhe të vlerëson me të vërtetë.

Libri "Sekreti i dashurisë" (The Secret of Loving) e bën shumë të qartë

që, nëse dashuria juaj është e bazuar vetëm në tërheqjen fizike dhe marrëdhënien seksuale, me shumë mundësi ajo është e caktuar të mos zgjasë për një kohë të gjatë! Ndonëse kjo mund të jetë emocionuese për një farë kohe, nuk i bën ballë provës së kohës ose sfidave dhe vështirësive që jeta do të sjellë në rrugën tuaj. Çfarë do të ndodhë kur sëmundjet e ndryshme ose kalimi i moshës do të cenojnë anën fizike; a do të jetë dashuria juaj aq e fortë dhe e thellë? A do t'i çmoni ende kohërat tuaja intime së bashku, edhe sikur kjo do të thotë thjesht të qenët së bashku, pa aspektin fizik?

Çfarë është intimiteti

Intimiteti do të thotë një marrëdhënie shumë e afërt, private dhe vetjake mes një bashkëshorti dhe një bashkëshorteje. Jemi duke folur këtu për dy njerëz që e njohin shumë mirë njëri-tjetrin, njohin zakonet, pëlqimet dhe mospëlqimet, shpresat dhe pritjet e njëri-tjetrit, ashtu sikurse kanë një njohje vetjake dhe private të trupave të njëri-tjetrit.

Natyrisht, ka nivele të ndryshme të intimitetit. Ne kemi miqësi shumë të afërta, vetjake me të tjerët, të cilët nuk janë pjesë e marrëdhënies intime martesore. Gjithsesi, marrëdhënia më intime në të cilën do të hyni ndonjëherë, në nivelin njerëzor, është ajo mes një bashkëshorti dhe bashkëshorteje në një martesë. Kjo marrëdhënie shumë intime është një mister për ata që nuk janë pjesë e saj. Fjalët e Urta 30:18, 19 thonë për këtë gjë: ... "Ka tri gjëra tepër të mrekullueshme për mua, madje katër, që unë nuk i kuptoj: ... dhe udha e burrit me një vajzë." Ka një aureolë misteri dhe çudie rreth gjithë procesit të njohjes së një burri dhe një gruaje: koha e propozimit, fejesa, ceremonia e martesës dhe pastaj përmbushja e atij zotimi të besnikërisë, derisa vdekja t'i ndajë! Vetëm ju dhe bashkëshorti/bash-

këshortja juaj e dini çfarë ndodh mes jush kur jeni vetëm. Ky është intimiteti. Diçka kaq e veçantë që është unike për ju të dy! Nuk ndahet me të tjerët!

Do të doja të shtoja një fjalë në lidhje me temën e veshjes. Fatkeqësisht shoqëria që na rrethon, edhe media, TV, filmat etj., janë duke dhënë një shembull shumë negativ se si duhet të vishet një grua. 1 Timoteu 2:9 thotë: "Po ashtu edhe gratë, të stolisin veten e tyre me rroba të ndershme, me cipë dhe modesti...". Çfarë do të thotë kjo për ne sot? Besoj se kjo është një nxitje për ne gratë që të vishemi në mënyrë femërore, por jo në mënyrë provokuese! Nëse trupi yt si grua është vetëm për burrin tënd, mos ia reklamo atë botës! Përveç bashkëshortit tënd, një gjë e tillë tërheq në epsh zemrat e burrave të tjerë dhe mundet, fare lehtë, të çojë në një marrëdhënie fizike jashtëmartesore. Perëndia e quan këtë mëkat! Vishu në një mënyrë që të mos ndihesh keq në publik dhe që as ti dhe as bashkëshorti yt të mos ndiheni në siklet. Në këtë mënyrë ju do të jeni duke i nderuar standardet e Perëndisë.

Intimiteti përfshin besim! Kemi folur për këtë në numrat e mëparshëm të revistës "Ilira", por më lejoni ta theksoj edhe një herë: Nuk mund të ketë intimitet të vërtetë nëse dyshimi ose mosbesimi janë të pranishëm në marrëdhënie! Kjo është shumë e rëndësishme. Dy njerëz, që janë me të vërtetë intimë me njëri-tjetrin, kanë nevojë të dinë që ata janë tërësisht të sigurt! Të njohësh intimitetin e vërtetë, duhet të përgatitesh ta bësh veten tërësisht të cenusëm ndaj këtij personi, i cili është bashkëshorti/bashkëshortja jote. Një pyetje për ju që jeni të martuar: A jeni tërësisht të lirë nga frika për t'i treguar diçka bashkëshortit/bashkëshortes suaj? Ose a mbani për vete gjëra, qoftë mendime, plane, ëndrra ose vetë trupin tuaj?

Një pasazh në Bibël, që flet shumë qartë për aspektin fizik të martesës është

1 Korintasve 7:2-5. Ky pasazh na mëson shumë qartë që një bashkëshort dhe një bashkëshorte ka një detyrë martesore për të përmbushur. Kjo gjë nuk është një mundësi për të zgjedhur. Kur ne martohemi, trupat tanë nuk i përkasin më vetes sonë, por bashkëshortit/bashkëshortes. Këtu ne nxitemi që të mos ia heqim bashkëshortit/bashkëshortes të drejtën e kësaj, përveç rasteve të një marrëveshjeje të përbashkët dhe, veç kësaj, vetëm për një kohë! Pastaj çifti duhet të bashkohet sërish në mënyrë që të mos e lejojë djallin t'i tundojë sërish për të mëkatuar! Efesianëve 5:28-31 mëson që në aktin fizik burri dhe gruaja bëhen një mish, pra ata bëhen pjesë e njëri-tjetrit. Një fjalë nga Hebrenjve 13:4 thotë: “Martesa të nderohet nga të gjithë, dhe shtrati martesor të jetë i papërlyer, sepse Perëndia do të gjykojë kurvarët dhe kurorëshkelësit.”

Më lejoni ta them sërish – nuk duhet të ketë marrëdhënie TJETËR fizike; vetëm ajo që Perëndia ka paracaktuar mes teje dhe bashkëshortit/bashkëshortes! Akti fizik është paracaktuar nga Perëndia dhe është i mirë, i drejtë dhe i bukur brenda kontekstit të një burri dhe një gruaje të martuar me njëri-tjetrin. Çdo gjë tjetër është mëkat dhe e pakënaqshme për Perëndinë.

Kjo është pjesë përbërëse e intimitetit brenda martesës, por nuk duhet të ndahet nga aspekti i njohjes së vërtetë të njëri-tjetrit në nivelin shpirtëror. Këto të dyja janë të gërshetuara ngushtë dhe nuk mund të kemi intimitet të vërtetë fizik pa pasur njohjen e thellë të bashkëshortit/bashkëshortes në nivelin shpirtëror të marrëdhënies.

Si mund të rritemi në intimitet?

Nëse ky intimitet i vërtetë është duke munguar, si mund ta bëni që të rritet? Ja disa sugjerime të cilat shpresoj se mund t'ju ndihmojnë në një martesë të përmbushur. Ndërmerrni hapa për ta njohur me të vërtetë bashkëshortin/bashkëshorten. Ne kemi një libër në shqip të quajtur “Pesë gjuhët e dashurisë” (The Five Love Languages). Këtu përmenden pesë hapa, si: 1) Fjalë pohuese, 2) Kohë cilësore, 3) Pranimi i dhuratave, 4) Vepra shërbimi dhe 5) Prekja fizike. Ju mund të jeni në gjendje të mendoni edhe për të tjera, por përdorini këto si bazë për të ditur se për çfarë ajo/ai gjen

kënaqësi, çfarë i intereson atij/asaj etj.

Mëso çfarë e kënaq bashkëshortin/bashkëshorten tënde dhe përpiku t'i plotësosh këto nevoja. E gërshetuar me këtë dhe me njohjen e bashkëshortit/bashkëshortes është edhe komunikimi! Flisni! Flisni! Flisni me njëri-tjetrin! Gjeneroni kohë për të bërë biseda të vërteta, jo vetëm për ditën e punës, fëmijët etj., por për zemrën, emocionet tuaja, çfarë je duke mësuar nga librat e Biblës etj. Intimiteti i vërtetë vjen kur jeni tërësisht të lirë nga frika për t'i treguar atë që është në zemrën tënde bashkëshortit/bashkëshortes. A e ke përjetuar ndonjëherë atë përvojën që e di çfarë do të thotë bashkëshorti/bashkëshortja ose përvojën e komunikimit pa fjalë? Nëse është kështu, ju po mësoni të jetoni në intimitet me njëri-tjetrin!

Ja disa mënyra praktike se si ta bëni dashurinë tuaj të rritet në intimitet:

Kaloni kohë së bashku në biseda të rëndësishme, ku eksploroni mendimet dhe ëndrrat e njëri-tjetrit, t'i tregoni njëri-tjetrit çfarë keni qenë duke mësuar nga Shkrimet etj. Kjo do të thotë të ruani për njëri-tjetrin një kohë së bashku pa shpërqendrim. Çfarë mendimi keni për një takim, të dilni për kafe ose për të bërë një shëtitje, një herë në javë?

Qerasje për ne, për mua dhe bashkëshortin tim, është të mos e vëmë zilen e zgjimit të shtunën në mëngjes dhe pas kësaj një kohë çlodhjeje, duke e pirë kafën së bashku në ballkon.

Mua më bënte kaq shumë përshtypje praktika e një prej ish-drejtuesve të misionit – ai caktonte në agjendë çdo javë një kohë për gruan e tij, kohë për familjen e tij. Nëse dikush e telefononte që të linte një takim ose ndonjë angazhim tjetër, ai e kontrollonte agjendën e tij dhe thoshte: “Më vjen keq por ajo pasdite/mbrëmje tashmë është e zënë.” Bëjeni këtë një praktikë në jetën tuaj! Një angazhim i kësaj natyre do t'ju ndihmojë në procesin e ndërtimit të intimitetit dhe po ashtu në rritjen e dashurisë së ndërsjellë. Bëjeni njëri-tjetrit dhurata të vogla domethënëse dhe të papritura. Nuk është e nevojshme që këto të kushtojnë! Burri im shpesh, veçanërisht gjatë kohës së pranverës, më befason me një buqetë të bukur lulesh, të cilat i ka këputur gjatë rrugës për në shtëpi nga ndonjë udhëtim. Kjo



ka më shumë domethënie sesa ndonjë buqetë e shtrenjtë e blerë! Mëso se çfarë e bën bashkëshortin/bashkëshorten të buzëqeshë dhe bekoje atë!

Për të testuar nivelin tuaj të intimitetit, si çift, mendoni për pyetjet që vijojnë: A jeni të lumtur kur jeni bashkë, pa njerëz të tjerë përreth? A i shijoni pushimet bashkë? A jeni të etur për të shkuar në shtëpi, pas një dite kur keni qenë larg? Sa të shpejtë janë hapat e tu drejt shtëpisë dhe drejt njeriut me të cilin je martuar? A mërzhiteni shpejt me njëri-tjetrin, apo a vazhdoni ende të befasoheni nga gjërat e reja që po mësoni?

Ti mund të mendosh se e njeh personin me të cilin po martohesh ndërkohë që qëndron pranë tij ditën e dasmës! Gjithsesi, ky është thjesht hapi i parë në këtë udhëtim që zgjat gjithë jetën!! Shumë çifte që kanë pasur martesë të gjata dhe të lumtura thonë që e kanë njohur bashkëshortin/bashkëshorten në një mënyrë shumë më intime tani pas 10, 20, 30, 50 etj. vitesh martesë! Dashuria e tyre është thelluar me kalimin e viteve të jetës së bashku. Intimiteti rritet me kohën. Është një udhëtim jete i njohjes së njëri-tjetrit më mirë, i thellimit të dashurisë suaj për njëri-tjetrin.

Lexime të rekomanduara

- “5 gjuhët e dashurisë” nga Gary Chapman. “Shigjeta”
- “Sekreti i dashurisë” nga Josh McDowell “OM”
- “Seksi dhe martesë” nga June Hunt “Radio 7”

Përktheu Erjon Ramaj



Çfarë duan femrat

Të dashur miq dhe mikeshë,
Përpara se të përgatitja këtë shkrim, bëra një pyetësor të thjeshtë me temën: “Çfarë duan femrat? dhe disa nga përgjigjet që mora nga të intervistuarit meshkuj ishin këto:

Femrat duan: para, pushtet, luks, pushime të shtrenjta, rroba firmato, dado për fëmijët dhe “grua” për të bërë punët e shtëpisë, vëmendje, llastime, një shtëpi në plazh etj.

Kur i lexon këto mendime për femrat, të zë frika, sepse ato paraqiten si

krijesa që të trembin, që të shkaktojnë vuajtje dhe “shpenzimë të mëdha”. Në fakt, femrat megjithëse duken qenie shumë të ndërlikuara dhe të “padeshifruara” nga meshkujt (duke cituar disa nga opinionet mashkullore), kanë disa nevoja thelbësore, të cilat nuk kushtojnë asnjë qindarkë për t’u plotësuar nga ana e meshkujve.

Madje mendoj që vetë meshkujt, nëse do t’i njihnin këto nevoja thelbësore të femrave dhe do të përpiqeshin sadopak për t’i plotësuar, do të habiteshin mbi

ndikimin që do të kishte kjo në marrëdhënien dhe në martesën e tyre.

Femrat kanë nevojë për dashuri e ngrohtësi dhe ngrohtësia është themeli i nevojshëm i marrëdhënies së tyre dashurore. Për pjesën dërrmuese të femrave, ngrohtësia barazohet me sigurinë, mbështetjen, mbrojtjen, rehatinë dhe miratimin nga ana e partnerit. Kur bashkëshorti i ofron gruas së tij ngrohtësi, ai është duke i dërguar asaj mesazhe, si:

- Unë do të kujdesem për ty, ndaj mos ki frikë! Je shumë e rëndësishme për mua!
- Në çdo hap që hedh, më ke me vete!
- Mendoj se je e mrekullueshme dhe kjo më bën mua një burrë me fat.

Ka meshkuj që nuk mund të shprehën si në një roman, por pa dyshim që dinë të dhurojnë një përqafim. Një përqafim, në fakt, i thotë mjaft qartë të gjitha ato që listova më sipër. Femrat i kanë shumë qejf përqafimet, pasi ato përqafojnë gjithë kohën fëmijët e tyre, mikeshat, kushërinjtë, kafshët shtëpiake etj. Ndaj burrat duhet të mësojnë që t’u tregojnë bashkëshorteve të tyre pak ngrohtësi përmes përqaftimeve.

Një kartolinë apo një shënim që ju, burra, mund t’u shkruani bashkëshorteve tuaja, ka të njëjtin efekt si një përqafim. Me fjalë të thjeshta dhe të sinqerta shprehuni bashkëshorteve tuaja, dashurinë dhe admirimin që ndieni për to.

Herë pas here femrave iu pëlqen që të marrin lule. Tani është bërë edhe më e lehtë që të gjesh lule të freskëta në rrugët e qytetit. Për shumë femra, lulet përçojnë një mesazh të fuqishëm dashurie dhe kujdesi. Mos ki turp të mbash në dorë një tufë lulësh që do t’i sillte shumë gëzim së shtrenjtës sate, që mezi pret që të kthehesh ne shtëpi.

Sipas mundësive financiare, ftojini bashkëshortet tuaja për një vakt jashtë në restorant. Me anë të këtij veprimi ju i shprehni mirënjohjen për kujdesin e përditshëm që ato tregojnë ndaj jush.

Hej, lexues “djema”, ne femrave na pëlqen që ndonjë ditë, krejt papritur, të shijojmë një vakt jashtë e të mos i shohim me sy tenxheret dhe tiganët. Nëse nuk keni mundësi që të shkoni në restorant, përgatitini bashkëshortes suaj një kafe apo një çaj dhe shërbejani edhe me ca biskota apo ndonjë ëmbëlsirë të

Një herë vajza e pyeti të ëmën pse ajo e piqte pulën në dy tava. "Sepse kështu e piqte gjyshja jote", ia ktheu e ëma. Atëherë vajza e pyeti gjyshen pse ajo e piqte pulën në dy tava.

"Ah, moj bijë, në kohën tonë nuk kishte tava mjaft të mëdha, prandaj e ndanim pulën në dy pjesë", ia ktheu gjyshja.

Kjo histori na kujton për një tjetër trashëgimi, atë të pavetëdijshtmen. Ne sjellim pa kuptuar në martesat tona një "valixhe sjelljesh dhe zakonesh" dhe të njëjtën gjë do ta bëjnë edhe vajzat tona. Martesa jonë, familja jonë është modeli i familjes që ato kanë parë më nga afër dhe modeli që do të marrin me vete. Në këtë aspekt, një nënë që e do babanë e fëmijëve të saj (dhe anasjelltas) është një dhuratë e paçmuar për fëmijët.

Një nënë që e do babanë e fëmijëve të saj bën një investim në brezat që do të vijnë. Por shpesh na ndodh të sillemi me bashkëshortët, pa e kuptuar, në të njëjtën mënyrë si nënat tona silleshin me etërit tanë. Por nëse ne e duam dhe e respektojmë bashkëshortin tonë, në të njëjtën kohë do të jemi duke mësuar dhe modeluar edhe tek vajza jonë dashurinë për bashkëshortin, dhe përmes saj edhe tek brezat që do të vijnë.

Prandaj përgjegjësia jonë është e madhe për komentet që bëjmë për bashkëshortët dhe qëndrimin që kemi ndaj tyre. Ja si mund ta shprehësh dashurinë ndaj tij:

1. Respektoje atë,
2. Lavdëroje shpesh në sy të fëmijëve,
3. Shpreh para tyre parapëlqimin tënd për atin e familjes.

Para disa kohësh kisha një mikeshë për vizitë në shtëpi. Vajza e saj i kërkoi t'i blinte një akulllore, por meqë dyqani ishte larg, mikeshja ime i tha se nuk do të shkonte aq larg në atë kohë për të blerë akullloren.

"Po sikur të dojë babi?", e pyeti vajza.

"Atëherë për babin do të shkoj", iu përgjigj mikja ime.

Fëmijët duhet të kuptojnë që mami e do babin e tyre mbi gjithë njerëzit e tjerë, edhe mbi ata vetë dhe se ata në fakt nuk janë qendra e botës.

4. Lutu për të bashkë me fëmijët.

Sa njerëz po luten për bashkëshortin tuaj sot? Ndërsa burrat përballen

sot me botën dhe sigurojnë të ardhurat për familjen, ata kanë nevojë për lutjet tona. Mua më ka ndihmuar një kartolinë e thjeshtë lutjeje që e mbaj në Biblën time. Është një gjë shumë e thjeshtë për t'u bërë çdo ditë. Pasi lutesh për të, thellohen edhe ndjenjat pozitive dhe rritet dashuria dhe dhembshuria për mikun tuaj të jetës. Lutu për të; në fakt lutu për të bashkë me fëmijët.

Së fundmi dhe më e rëndësishmja, thesari më i çmuar që mund t'i lësh vajzës sate është: DISHEPULLOJE - mësoje të njohë Krishtin dhe të dojë fjalën e Tij.

Jeremia 9:23-24 «Kështu thotë ZOTI: "I urti të mos lavdërohet me urtësinë e tij, njeriu i fortë të mos lavdërohet me forcën e tij, i pasuri të mos lavdërohet me pasurinë e tij. Po kush lavdërohet, të lavdërohet me këtë: të ketë gjykim dhe të më njohë mua që jam ZOTI, që ushtrij mirësinë, gjykimin dhe drejtësinë mbi tokë; sepse kënaqem me këto gjëra", thotë ZOTI.»

Kultura sot ushtron shumë presion se si fëmijët duhet të pajisen për të pasur sukses, të shkojnë në shkollat më të mira, në universitetet më të njohura, të njohin shumë gjuhë të huaja. Sa shumë kohë e energji investojmë për kurset e ndryshme, si p.sh. tenis, piano, balet, pikturë etj. Ne duam që fëmijët tanë, vajzat tona të jetojnë kapacitetin e tyre të plotë intelektual dhe të jenë të suksesshme në jetë. Pyetje si: "Çfarë do të bëhet fëmija im? A do të jetë ai/ajo i suksesshëm në jetë?", i kemi si çekiç në kokë herë pas here. Përveç kësaj, nuk matemi dot me gjithë morinë e lodrave, ipad, ipod, laptopave dhe duam që ata të mos ndihen të privuar nga gjithë këto gjëra.

Por çfarë çlirimi vjen kur lexon Fjalën e Zotit! Më e rëndësishmja nga të tëra është të njohin Atë.

Nuk po them se është gabim ta ndihmosh fëmijën tënd të zhvillohet intelektualisht dhe të sigurosh mënyra si të zbulojë e të zhvillojë talentet që Perëndia i ka dhënë, por parësore është të njohë Zotin dhe të tjerat (që ne pa e kuptuar në jetën e përditshme i bëjmë të parat) janë dytësore.

Më kujtohet që kur isha 10-11 vjeç, babi bleu disa kapëse flokësh me gurë, varëse dhe bizhuteri të tjera, që në atë kohë konsideroheshin me vlerë. Mami

NJË NËNË QË E DO BABANË E FËMIJËVE TË SAJ BËN NJË INVESTIM NË BREZAT QË DO TË VIJNË.

nuk na linte mua dhe motrën t'i vinim, sepse donte që "t'i kishim kur të rriteshim".

Kur ne u rritëm, nëpër dyqane kishte kaq shumë varëse e kapëse flokësh, saqë ne, në fakt, asnjëherë nuk i shijuam ato që babi na kishte blerë atëherë.

Pasuritë, intelëkti, sukcesi shoqëror janë në duart e Perëndisë. Të mbledhësh "pasuri në tokë, ku i bren tenja dhe ndryshku" nuk është trashëgimi që do të zgjasë.

Njohja e Perëndisë dhe të kuptuarit e Tij është trashëgimia më e vlefshme që unë dëshiroj t'i lë vajzës sime.

Është një dritare kohe në jetën e vajzave (para se të fillojnë hormonet e adoleshencës), ku ato i duan dhe adhurrojnë nënat e tyre. Fillojnë vishen si nëna e tyre dhe duan të gatuajnë si ato. Duhet ta shfrytëzojmë këtë kohë për të ndërtuar zakone që ato do t'i kenë për gjithë jetën.

Nëse unë dua që ime bijë të ndjekë Zotin, duhet ta ndjek dhe ta njoh Atë. Duhet të bëhem shembulli që ajo ndjek.

Ndërsa lexoj fjalët që këto vajza dikur të vogla, tashmë të rritura dhe disa prej tyre nëna, kanë shkruar, po mendoj çfarë dua unë të shkruajnë vajzat e mia (njëra 9 vjeç dhe tjetra e sapolindur) për nënën e tyre.

Ajo që do të doja patjetër të shkruajnë është "nëna jonë nuk ishte e përsosur, por ajo e lexonte Biblën dhe lutej çdo mëngjes. Na mësoi si të duam Zotin dhe ta studiojmë Fjalën e Tij."

Bashkudhëtare me ju në prindërim, "Nëse Zoti nuk ndërton shtëpinë, më kot lodhen punëtorët."

*Shkroi dhe përgatiti,
Maklen Menalla,
Jetë Familjare*



I ntimiteti

Pjesa e dytë

Shumë pak gjëra në jetë kanë aq forcë për të na sjellë lumturi, sa marrëdhëniet familjare. Anasjelltas, shumë pak gjëra mund të na sjellin dhimbje sa marrëdhëniet e shkatërruara familjare. Familja e ka humbur udhën e saj, familja është sulmuar nga zëra kontradiktorë. Çdo gjë që ndodh në familje ndikon mbi kombin, madje edhe mbi botën mbarë, për mirë ose për keq.

Një karakteristikë e dytë e një familje të shëndetshme është ekzistenca e intimitetit midis burrit dhe gruas. Bashkuam emrat tanë sepse dëshironim të bashkonim jetët tona në një ëndërr të përbashkët të lumturisë. Fjala intimitet vjen nga latinishtja *intimus*, e cila do të thotë "i brendshëm". Kështu intimiteti përfshin 2 njerëz, të cilët zbulojnë botën e tyre të brendshme para njëri-tjetrit. Intimitet do të thotë të hysh në jetën e njëri-tjetrit emocionalisht, në mënyrë intelektuale, shoqërore, fizike dhe frymërore. Intimiteti lidh thellë çdo nivel të mundshëm, ai lidh çdo aspekt të jetës. Intimiteti shoqërohet me ndjenjën e dashurisë dhe besimit. Ne besojmë se tjetri mendon për më të mirën e interesave tona dhe nuk kemi

frikë se mendimet dhe veprimet tona do të përdoren kundër nesh.

Gruaja dhe burri janë individë që dallojnë nga njëri-tjetri, por që lidhen me njëri-tjetrin nga ana fizike, emocionale dhe frymërore. Ka diçka në brendësi të burrit që thërret për gruan dhe diçka e gruas që dëshiron shoqëri me burrin. Intimiteti seksual është aspekt i bashkimit. Pjesa dërrmuese e çifteve mund të hedhin vështrimin e tyre në të shkuarën, në një periudhë kohe të marrëdhënieve të tyre që quhej "periudha e dashurisë". Atëherë përjetuan një ndjenjë të fortë afërsie. Kur "etapa e dashurisë zhvillohet plotësisht, atëherë kemi një ndjenjë përkatësie ndaj njëri-tjetrit. E ndjejmë se deri diku, ishim bërë për njëri-tjetrin.

E ndjemë në zemrat tona se do ta duam njëri-tjetrin përjetë, se e duam lumturinë e njëri-tjetrit mbi gjithçka tjetër dhe se lumturia jonë varet nga të qëniet me këtë njeri për jetë. Është kjo ndjenjë e thellë e intimitetit që na jep kurajën për t'ia kushtuar jetën tonë martesës. Mund ta fillojmë martesën tonë me një masë të lartë intimiteti, por në një pikë, ne e zvogëlojmë intimitetin

me izolim. Si ndodh kjo humbje e intimitetit? Shumë çifte e përshkruajnë këtë si mur që ngrihet midis tyre.

Si mund të fitohet intimiteti? Përgjigja është e thjeshtë, por jo e lehtë. Muri duhet rrëzuar! Në momentin që ti pranon hapur dështimet e tua në jetë dhe kërkon falje, muri në anën tënde rrëzohet. Nëse bashkshort-i (ja) të fal



dhe për rrjedhojë i pranon gabimet e veta, atëherë muri rrëzohet në të dyja anët dhe intimiteti kthehet pothuaj menjëherë. Askush nuk është i përkryer. Herë pas here e zhgënjejmë njëri-tjetrin, por nëse kemi vullnetin për t'i pranuar dështimet tona dhe për të kërkuar falje, atëherë kemi mundësi ta mbajmë murin të rrëzuar.

Ndërtimi i intimitetit është proces. Procesi me të cilin mbajmë intimitetin, është komunikimi i shëndoshë. Zbulon mendimet, ndjenjat dhe përvojën e vet, ndërsa i pari dëgjon dhe kërkon ta kuptojë. Procesi i thjeshtë i bisedës dhe i dëgjimit mban intimitetin. Ne nuk jemi lexues të mendjes. Vetëm atëherë kur zbulojmë veten para njëri-tjetrit mund të vazhdojmë të ushqejmë ndjenja

intimiteti midis nesh. Pse kjo aftësi njerëzore e thjeshtë, për të biseduar dhe për të dëgjuar bëhet kaq e vështirë brenda martesës? Intimiteti i ka rrënjët në përjetimin së bashku të pasioneve, emocioneve, mendimeve, përvojave,

dëshirave dhe shqetësimeve. Çfarë e pengon rrjedhën e lirë të komunikimit, në një nivel të tillë emocional? Pavarësisht nga arsyeja, disave prej nesh u është mësuar që t'i fshehim apo mohojmë emocionet. Dhimbja e thellë emocionale e përjetuar në fëmijëri, i ka dhënë ngjyrë realitetit të tyre si të rritur. Ndjenjat rrinë të fshehura diku thellë brenda njeriut.

Arsyeja e dytë se përse nuk kemi dëshirë t'i diskutojmë emocionet tona është frika nga reagimi i burrit apo i gruas. Ne kemi frikë se ai ose ajo do të na qortojë për atë që ndjejmë, do të zemërohet dhe do të na kundërshtojë. Arsyeja e tretë është koncepti gabuar se disa emocione nuk janë të pranueshme. Një arsye tjetër që disa individë nuk bisedojnë rreth emocioneve të tyre, është se ata asnjëherë në të shkuarën, nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Një arsye tjetër: "Nuk dua ta ngarkoj burrin apo gruan me përndjekjet e mia emocionale." Një pohim i tillë tingëllon si përkujdesje në sipërfaqje dhe personi ndoshta vërtet kërkon të dijë interesat e partnerit. Kështu ne i mohojmë partnerit mundësinë për të hyrë në intimitet dhe të luftojë bashkë me ne.

Ne nuk u martuam për të gjetur një

mënyrë të përshtatshme gatimi, për të larë enët, rrobat, makinat dhe për të rritur fëmijët. Ne u martuam duke u nisur nga dëshira e thellë për të njohur njëri-tjetrin, për të dashuruar njëri-tjetrin, për ta jetuar jetën së bashku, me besimin se kështu, mund ta përjetonim më thellësisht, sesa veç e veç.

Ne u martuam:

- Që të shprehim mendimet tona.
- Që të diskutojmë ndjenjat tona.
- Që të kalojmë një farë kohe së bashku dhe diskutojmë për kohën që kemi kaluar larg njëri-tjetrit.
- Që t'i hapim zemrën njëri-tjetrit.
- Dhe që trupat tanë bëhen një.

Secili prej nesh jeton brenda mendjes së vet. Edhe nëse jemi në të njëjtën dhomë, ose shumë kilometra larg njëri-tjetrit, mendja jonë vlon nga mendimet. Në qoftë se kërkojmë intimitet, ne duhet të zgjedhim rrugën e shfaqes se këtyre mendimeve ndaj njëri-tjetrit. Është e qartë se ne duhet të përzgjedhim. Mundësia e diskutimit të të gjitha mendimeve është absurde. Jeta nuk është aq e gjatë. Nga ana tjetër nëse nuk i tregojmë njëri-tjetrit asnjë nga mendimet tona, kjo sjell humbjen e intimitetit. Çdo ditë, jeta është e mbushur me ndjenja. Jeta juaj e brendshme është e mbushur me ndjenja dhe askush nuk i sheh ato. Diskutimi i ndjenjave ndërton intimitet emocional.

Të mësuarit për të biseduar rreth emocioneve mund të jetë një nga përvojat më shpërblyese të jetës. Të tilla diskutime kërkojnë atmosferë pranimit.

Diskutimi i ndjenjave pozitive na lejon të hyjmë në gëzimet e njëri-tjetrit. Në të njëjtën mënyrë, edhe kur flasim për ndjenjat negative ne gjithashtu krijojmë intimitet emocional.

Diskutimi i ndjenjave, gëzimeve dhe hidhërimeve, është një nga aspektet më të kënaqshme të martesës. Kur ne i tregojmë emocionet, ne përfshijmë partner-in (en) në një pjesë shumë të fuqishme të jetës sonë. Emocionet pozitive të përjetuara së bashku rrisin gjithë kënaqësinë. Në të njëjtën mënyrë përjetimi i përbashkët i emocioneve negative duhet të sjellë gjithnjë lehtësim dhe mbështetje.

Bashkimi i intimitetit veti me atë të partnerit, është filli me të cilin thurim intimitetin martesor. Është pikërisht

kjo që mendonim se e kishim në fillim, kur u martuam dhe dëshironim ta kishim përjetë. I jep kënaqësi skutave të brëndshme të çiftit dhe në qoftë se ata kanë fëmijë, shërben si model shëmbullor i familjes. Dëshira për intimitet martesor ndikon fuqishëm në të gjitha aspektet e jetës. Së pari ajo ndikon mbi mënyrën e trajtimit të njëri-tjetrit. Më pas, ndikon mbi mënyrën e lidhjes së tyre me fëmijët. Kur intimiteti midis burrit dhe gruas ekziston, rezultatet do të krijojnë një mjedis të shëndetshëm, të favorshëm për rritjen e fëmijëve. Aty ku nuk ekziston, fëmijët do të rriten në një zonë lufte, gjurmët e së cilës mund t'u mbeten për gjithë jetën. Ekziston diçka brenda fëmijës që thotë: "Ja kjo është mënyra si duhej të ishte."

Përgatiti: Valbona Avdullaj

Referenca: "Pesë tregues për një familje të shëndetshme" nga Gary Chapman

Sokrati ka thënë: "Nëse do të shkoja në pikën më të lartë të Athinës, unë do të bërtisja: Ç'kuptim ka të dashur bashkëqytetarë që ju s'lini gurë pa lëvizur për të grumbulluar pasuri, ndërsa kujdeseni kaq pak për fëmijët tuaj, të cilëve, një ditë do t'ua lini të gjitha?" Në pjesën e tretë zbulohet tema: Drejtimi i fëmijëve në mënyrë krijuese.





Pastërtia seksuale në fejesë

Nga Genti dhe Djana Shani

Të dy së bashku si çift kemi pasur privilegjin të bashkërendojmë prej disa vitesh kursin «Të përgatiteni për martesën tuaj», ku pjesë e tij është edhe projekti «Besëlidhja e pastërtisë». Pjesëmarrës në këtë kurs janë kryesisht çiftet e fejuara, që po bëhen gati për të kurorëzuar dashurinë e tyre në një martesë të perëndishme.

Duke marrë shkak nga kjo përvojë, në këtë artikull duam të ndajmë me ju parimet që mësojmë dhe të cilave u besojmë, të ilustruara me mendimet e një çifti, i cili sapo ka përfunduar me sukses rrugëtimin e tij në fejesë, për t'ia dhënë veten tjetrit plotësisht në martesë.

“Ruajtja e pastërtisë seksuale para martesës është si një ndëshkim mizor dhe i pazakontë” – kjo është ajo çfarë na thotë këndvështrimi i botës.

Po jetojmë në kohën e një kulture të çmendur! Interneti, muzika, televizioni, filmat, telenovelat, “reality show” po i inkurajojnë njerëzit të shkojnë deri në fund. Seksi është bërë një fiksion kulturor. Pamja e seksit që pasqyron kultura jonë është një zvetënim i planit fillestar të Perëndisë. Ashtu si thika e një kirurgu, e cila është krijuar për të bërë mirë, por mund të përdoret për të bërë dëm nëse vihet në duar të gabuara, ashtu edhe seksi është shtrembëruar, larg qëllimit fillestar për të cilin u krijuar.

Zoti është ideatori dhe krijuesi i marrëdhënies intime. Por Zoti e krijoi marrëdhënien intime për ta shijuar në martesë. “Për këtë arsye, njeriu do të braktisë babanë dhe nënën e tij dhe do të bashkohet me gruan e tij dhe do të jenë një mish i vetëm”, thotë Zanafilla 2:24.

Ekziston një linjë e përbashkët e të menduarit në kulturën e sotme, sipas së cilës një çift, i cili ka vendosur të martohet, duhet të provojë përputhshmërinë e tij seksuale para se të martohen. Pra, është një lloj mentaliteti “provoje para se ta blesh”! Por nëse përputhshmëria seksuale do të ishte një parakusht për martesën, atëherë natyrshëm Perëndia do ta kishte bërë të qartë në Shkrimin e

Shenjtë. Vetëm ngaqë një person është i aftë për intimitet fizik, jo domosdoshmërisht është i aftë për të mbajtur edhe një martesë të bashkuar. Dashuria është e durueshme dhe një çift që është i sigurt në dashurinë e vet, e di që do të ketë gjithë pjesën tjetër të jetës së vet për ta shijuar seksin.

Pse është e rëndësishme pastërtia seksuale në fejesë?

Kjo ishte pyetja që i bëmë çiftit të ri, të sapomartuar, dhe ja si u përgjigjën: “Së pari, shmanget ndjesia e fajit përpara Perëndisë. Në fillim të martesës duhet të përshtatemi dhe ka raste kur ende duket si ndjenjë faji derisa të mësohesh. Imagjino si do të ndiheshim nëse do të ishte jashtë kontekstit martesor. Ndjenja e fajit do të na rëndonte shpirtin.

Së dyti, pasiguritë dhe problemet në çift çojnë shpesh në mendime se nuk jemi për njëri-tjetrin. Nëse do të ndaheshim dhe jemi të përfshirë në marrëdhënie seksuale, atëherë kjo do të linte njollë në emocionet dhe trupat tanë.

Së treti, ne nuk lëmë asgjë të re për martesën, sepse çdo gjë është konsumuar më parë.”

Perëndia kishte më të mirën në

mendje për ne kur Ai na dha porosi të forta lidhur me pastërtinë seksuale para martesës. “Martesa të nderohet nga të gjithë dhe shtrati martesor i papërlyer, sepse Perëndia do të gjykojë kurvarët dhe kurorëshkelësit.” (Hebrenjve 13:4)

Pastërti seksuale do të thotë më shumë sesa të mos kryesh marrëdhënie seksuale para martesës. Shumë çiftet e shmangin marrëdhënien, por, megjithatë, kanë intimitet seksual. Bibla na e sugjeron pastërtinë seksuale si “mënyrën për të qenë të shkëlqyer nga ana morale” dhe shkëlqim moral do të thotë të jesh i/e shenjtë. Do të thotë, pastërti në mendje, si edhe pastërti në vepra. Do të thotë të mbrojmë pafajësinë e njëri-tjetrit, për të mos u njollësuar nga ligësia. “Prandaj unë përpigem vazhdimisht të kem një ndërgjegje të paqortueshme përpara Perëndisë dhe përpara njerëzve.” (Veprat 24:16.)

Po jua paraqesim në mënyrë të përmbledhur përfitimet që kemi nga pastërtia në fejesë:

- Ju kënaqni Perëndinë.
- Ju jeni të mbrojtur nga trauma emocionale, mendore dhe fizike, nëse do t’ju duhet të ndërprisni marrëdhënien përpara martesës.
- Ju ndiheni të lirë për ta njohur personin tjetër ashtu siç përcaktoi Perëndia për ta njohur para martesës. Çiftet të cilat kanë marrëdhënie intime gjatë fejesës, e humbin atë aftësi për të parë më thellë në marrëdhënie, në të kaluarën e tyre, në të tashmen dhe në të ardhmen. Marrëdhënia seksuale mund t’i verbojë ata kaq shumë, sa të mos kuptojnë që marrëdhënies së tyre i mungon intimiteti i vërtetë.

Si mund ta ruajmë njëri-tjetrin nga tundimet?

Me të drejtë, mund të pyesim: Po ne na kanë mbetur vetëm disa javë nga dita e martesës. Pse të mos fillojmë ta provojmë që tani atë çka na është premtuar në martesë?

Ky lloj të menduari është i gabuar. Në këtë rast, duhet të vazhdojmë të presim me besim, me një besim të shenjtë, derisa formalizimi i lidhjes të vijë. Do të ishte e vështirë të dallojmë pikëku fillon vërtet “formalizimi” e ku fillon “përshtypja sikur gjithçka është formalizuar”. Të fejuarit duhet të mësojnë të

presin nga njëri-tjetri dhe t’i besojnë njëri-tjetrit.

Më poshtë vijojnë disa hapa që ndihmojnë për të pritur në këtë fazë:

1. Lutuni individualisht dhe së bashku.

Ne e dimë se nuk mund të fitojmë vetë asnjë betejë, por kemi nevojë për Zotin. Ndaj lutja do të na ndihmojë për të qëndruar të fortë.

2. Vendosni kufij në marrëdhënien tuaj.

Çifti ynë i sapomartuar na tregon për kufijtë që kishin vendosur gjatë periudhës së fejesës:

- Ne do t’i shmangim prekjet fizike apo përkëdheljet në vende të ndjeshme, të cilat do të shkaktonin epsh dhe dëshirë për intimitet fizik.
- Nuk do të rrimë vetëm në orët e vona të natës.
- Do t’i shmangim vendet e errëta dhe të vetmuara, sidomos në shtëpi.

3. Krijoni një marrëdhënie përgjegjshmërie.

Zgjidhni një person tek i cili keni besim, që mund të jetë një shok ose një mentor, dhe ndani me të tundimet dhe përjetimet tuaja.

Cili është standardi juaj? Sa larg shkon vija juaj e kufirit? Cili do të jetë standardi juaj në lidhje me pastërtinë seksuale? Me ndihmën e Zotit mund të përballojmë çdo tundim. (1 Korintasve 10:13) Ai gjithmonë na jep një rrugëdalje, ndërsa ne zgjedhim.

Si mund t’i japim zemër njëri-tjetrit për të qëndruar dhe pritur deri në fund?

Një shqetësim që vjen kryesisht nga vajzat është presioni nga të fejuarit për të pasur një marrëdhënie intime gjatë fejesës. Ky presion është një shenjë mosrespekti, një mungesë udhëheqjeje shpirtërore, një mungesë respekti për njeriun e brendshëm. Martesa është e vështirë dhe nëse që tani nuk keni një respekt të ndërsjellë dhe një harmoni shpirtërore, në martesë shenjat do të jenë më alarmante. Çifti që intervistuar na tregoi disa prej vendimeve që kanë marrë së bashku për të pritur deri në fund:

Në bindje ndaj urdhërimit të Perëndisë, unë premtoj të mbrojmë pastërtinë tënde seksuale që nga kjo ditë deri në muajin tonë të mjalitit. Ky është premtimi im i pastërtisë.

Nënshkruar

“Ne vendosëm një pakt me njëri-tjetrin se nuk do ta shkelnim urdhrin e Zotit. Mësuam vargje përmendsh. Lexuam libra rreth fushës.”

Përmes këtyre mendimeve po ju sugjerojmë një besëlidhje pastërtie që nënshkruhet midis të dy partnerëve, për të ndihmuar njëri-tjetrin të mbrohen deri në martesë. “Sepse ky është vullneti i Perëndisë: shenjtërimi juaj; të hiqni dorë nga kurvëria; që secili prej jush të dijë ta mbajë enën e vet me shenjtëri dhe me nder, jo me pasione epshi...” (1 Thesalonikasve 4:3-8)

Shumë nga ata që janë duke e lexuar këtë artikull sot e dinë se çfarë është e drejtë. Disa kanë nevojë të pendohen, të tjerë, që kanë dështuar dhe janë penduar, kanë vendosur disa standarde më të larta. Të gjithë duhet të kthehemi tek Shkrimi dhe të kuptojmë se Jezu Krishti na ka falur. 1 Gjonit 1:9 thotë se “nëse i rrëfejmë mëkatet tona, Ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi.”

Duke pasur parasysh se sa sfidues mund të ketë qenë ky artikull, ne gjithmonë duam të shpallim se kur terrenin tonë e lëmë në këmbët e Jezusit, Ai di ta sheshojë atë gjithnjë.

Nëse qëndroni në premtimet e Krishtit, atëherë do të përjetoni bollëkun e Tij, edhe nëse të tjerët në botë rreth e rrotull jush, do të jenë mosbesues kur të dëgjojnë për standardet tuaja të pastërtisë.

Përgatitën dhe shkruan
Genti dhe Djana Shani
JetëFamiljare
jetefamjare@albaniacc.org
familja@jetefamiljare.org
www.jetefamiljare.org



Komunikimi në familje

Disa ide për komunikimin në familje

Fëmijët kanë mendje shumë aktive dhe veshi iu kap shumë gjëra për të cilat flasin të rriturit. Ata mund të mos i kuptojnë të gjitha gjërat që dëgjojnë, por krijojnë domethënie dhe situata për të shpjeguar gjërat që ndodhin në jetët e tyre.

Një mikja ime, ishte vetëm pesë vjeçe, kur mësoi se çfarë ishte poliomieliti. Mësoi që ishte një sëmundje e tmerrshme që mund ta marrësh nga njerëzit e tjerë dhe që të shkakton paralizën e gjymtyrëve, aq sa të mos jesh në gjendje të ecësh. Jo shumë kohë pasi e mësoi këtë, dëgjoji që një burrë, një polic ishte duke ardhur te shtëpia e tyre. Në momentin që ajo dëgjoji "polic", në veshët dhe mendjen e saj ajo dëgjoji 'poliomielit', kështu që në mënyrën se si e kuptonte, një burrë po vinte në familjen e saj për t'iu dhënë atyre poliomielin. Kur burri erdhi, ajo u mërzit aq shumë, saqë jo vetëm që nuk foli, as përshëndeti,

por shkoi drejt e tek ai dhe e gjuajti me shkelm. Prindërit i bërtitën dhe ajo mori edhe një shpullë të mirë. Ndërkohë që babai i saj po fliste me të, me lot në sy, tha me nxitim: "Por pse e lejove atë të hynte brenda, ai do të na e ngjitë poliomielin, a nuk e di se çfarë është?" Prindërit e saj më në fund e kuptuan gabimin dhe me dashuri i shpjeguan asaj çfarë ishte një polic sigurimi.

Mua më kujtohet, që fjalët mekanik dhe maniak, ishin ngatërruar në mendjen time e kështu mendoja që në një servis makinash kishin punësuar "një maniak" në punë, në vend të një mekaniku për të riparuar makinat.

Si rezultat i keqkuptimit, fëmijët mund të kenë shumë frikëra dhe nuk e dinë kë apo kur mund të pyesin për t'u sqaruar.

Është e rëndësishme të kesh një kohë mënjane për të komunikuar me fëmijët! Gjithashtu është e rëndësishme të kesh kohë me secilin

fëmijë një nga një, çdo ditë!

Qoftë edhe një kohë të shkurtër prej 10 minutash, mund të jetë një ndihmë. Kjo është një kohë ku ju bashkëveproni me një fëmijë. Përpiquni që të mos ketë ndërprerje. Është mirë që të dy prindërit, të kenë një kohë të tillë. Gjithashtu ora e gjumit është një kohë e mirë për t'i pyetur fëmijët për ditën e tyre, apo edhe nëse ata kanë ndonjë pyetje për diçka që mund të ketë ndodhur gjatë ditës. Përgjigjuni dhe shpjegoni çdo pyetje me kujdes. Asnjëherë mos u shfaqni shumë i tronditur, i mërzitur apo i mbytur në lot, sepse emocionet e tepërta mund t'i alarmojnë fëmijët dhe mund ta shuajnë komunikimin e mëtejshëm.

Një baba ishte duke e vënë në gjumë djalin e tij; ata jetojnë në Afrikë dhe shërbejnë si misionarë atje. Djali i tij po i tregonte për ditën interesante që kishte pasur duke luajtur jashtë. I tregoi që kishte gjetur një gjarpër afër garazhit, por që babai nuk duhej

të shqetësohej aspak për këtë, sepse ai i kishte hedhur gurë dhe e kishte plagosur. Pastaj i ishte afruar, e kishte kapur gjarpërin dhe kishte lidhur një nyje në të. Meqë djali i tij e dinte që gjarpërinjtë ishin të ligj dhe mund t'ju bëjnë keq njerëzve e ai nuk do të dëshironte që ai të ngrihej dhe t'i bënte keq askujt.

Brenda vetes i ati ishte i lemerisur, sepse e dinte që kishte shumë gjarpërinj helmues në atë zonë dhe një gjarpër i trullësuar mund të vinte në vete shumë shpejt. Ai kishte dëgjuar për gjarpërinj që ishin rrahur me shkop dhe më vonë e kishin rimarrë veten dhe kishin ikur duke u zvarritur. Pa e humbur qetësinë ai e pyeti të birin, ku e kishte lënë gjarpërin, dhe nëse mund t'ia tregonte të atit ku ishte. Të dy u ngritën dhe ecën pas garazhit dhe aty e gjetën të ngordhur mbretin helmues kobra, me një nyje në mes!

Ruani qetësinë kur dëgjoni!

Në qoftë se babai në këtë rast do ta kishte shfaqur frikën e tij, i biri mund të mos ia kishte treguar të tërë historinë.

Kur djali ynë filloi të shkonte për herë të parë në kopshtin e fëmijëve në afërsi të shkollës publike, e gjithë atmosfera e kaq shumë fëmijëve në të njëjtin vend, dhe pritja për t'u sjellë mirë ishin krejtësisht të reja për të. Ai ishte një fëmijë i ndjeshëm dhe dëshironte të bënte gjënë e duhur. Pasi vinte nga shkolla, ulej dhe ndiqte në TV programin e tij të preferuar, i cili fatëqësisht përmbante një farë dhune. Ndërkohë që ishte i ulur, ai vërtiste ca fije floku nëpër gishta dhe pastaj i shkulte. Pa kaluar shumë kohë, ai kishte zhveshur një pjesë të madhe në majë të kokës, duke e bërë tullac. Pastaj ne kërkuam ndihmën e një mikeje, e cila ishte punonjëse sociale. Për fat të keq, nuk ka shumë burime ku prindërit të drejtohen

për ndihmë, por fatmirësisht ishte një grup në zonën tonë. Ajo sugjeroi që ne të merrnim pjesë në klasat e prindërimit, gjë që e bëmë. Këto klasa na hapën sytë. Fokusi kryesor, ishte se si të komunikim me fëmijët dhe si të krijojmë një lidhje të ngushtë me ta.

Përmirësoje atmosferën në shtëpi, në mënyrë që shtëpia të jetë një vend i sigurt për komunikimin!

Një mjet komunikimi janë takimet familjare. Kjo mund të ndodhë formalisht ose jo formalisht.

Të caktosh një takim familjar në mënyrë formale është të caktosh një kohë, kur e gjithë familja mblidhet së bashku, ku merren shënime dhe udhëheqja bëhet me radhë.

Përmirësoje atmosferën në shtëpi, në mënyrë që shtëpia të jetë një vend i sigurt për komunikimin!

Takimet familjare jo formale, janë mbledhja për një kafe në kohë të ndryshme dhe komunikimi si një familje.

Familja jonë organizonte takime formale. Ishte një kohë e mrekullueshme dhe tani kur kthej kokën pas, kujtoj me dashuri kohët kur ne uleshim rreth tryezës dhe dëgjojmë zërat e fëmijëve tanë.

Udhëheqja e takimeve bëhet me radhë dhe gjithashtu mbajtja e shënimeve. Më kujtohet tek shikoja ato duar të vogla që mbanin shënime dhe shlyenin. Gjithmonë thekso që fëmijët të jenë krejtësisht të hapur e të thonë çdo gjë, në takimet familjare. Gjërat për të cilat fëmijët tanë diskutonin ishin për shembull, që dy dollarë nuk ishin mjaft, për para xhepi për një javë.

Gjithashtu, kjo është një kohë e mirë

për të planifikuar kohën e pushimeve dhe kohë të tjera me familjen, të diskutosh punët e familjes, të vendosësh rregullat e disiplinës. Përpiquni të arrini një marrëveshje për vendin që do të zgjidhni për pushimet, por nëse nuk arrini në një marrëveshje, (ka plot gjëra, për të cilat nuk janë të gjithë në të njëjtën mendje), babai le të jetë ai që do ta caktojë vendin.

Ne e quanim shtëpinë tonë një shtëpi për njerëz që nuk fshihen, gjithashtu, një vend pa emra. Kjo do të thoshte që ne nuk do t'i thërrisnim kurrë njëri-tjetrit me emra negative si; budalla, i trashë, ose fjalë të tjera ofenduese, dhe njerëzit që godisnin njëri-tjetrin kishin pasoja serioze.

Gjithmonë, lutuni me fëmijët, para se ata të flenë.

Kur fëmijët tanë ishin të vegjël ne luteshim së bashku pranë krevateve të tyre. Kur u bënë adoleshentë, uleshim në dhomën e ndenjies dhe lexonim Biblën së bashku; ndanim kërkesat e lutjes dhe luteshim. Çdo mik që vinte në shtëpi duhej të merrte pjesë, edhe nëse ishin jobsimtarë.


Sara, ishte një nga shoqet e Melit. Ajo do të vinte tek ne një pasdite dhe do të ishte atje në kohën tonë të zakonshme të lutjes. E dinim që ajo nuk ishte besimtare dhe që babai i saj ishte mysliman. Gjithsesi ne ndjemë që duhet të vazhdonim praktikën e familjes, por asaj nuk do t'i kërkohej që të lutej. Në fakt ajo mori pjesë madje edhe u lut. Pastaj e pyeti vajzën tonë, "E bën familja jote çdo natë këtë takim lutjesh?"

Më vonë ajo e pranoi Krishtin. Kur u pyet se çfarë e kishte ndikuar atë, ajo tha, "Kontakti që pata me familjet e krishtera të miqve të mi."

Nga Sindi Helvi

Çfarë duan femrat

Pjesa e dytë



Të dashur miq dhe lexues të revistës “Ilira”,

Sa herë që bëhem gati për të shkruar një shkrim të ri, bisedoj më parë me njerëz të ndryshëm dhe kërkoj edhe opinionin e tyre në lidhje me temën e përzgjedhur. Të njëjtën gjë bëra edhe këtë javë dhe u mahnita nga larmia e përgjigjeve të dhëna. Njëra syresh qe e tillë: “Femrat duan /rr/ të fortë tek fjala burrë”. Këmbëngula në shpjegimin e kësaj përgjigjeje të dhënë nga një zonjë dhe ajo më shpjegoi që rr-ja e fortë për të nënkuptonte: kujdes, dashuri, liri, mirëkuptim, durim për ta dëgjuar, siguri etj.

90% e femrave të intervistuar flasin për të njëjtën nevojë: për bashkëbisedim me bashkëshortët e tyre. Në fakt dëshiroj që t’ju bëj një pyetje edhe juve që po e lexoni këtë shkrim. A e mbani mend se sa gjatë bisedonit me të dashurin/të dashurën në kohën e njohjes? Në të vërtetë, sidomos gjatë periudhës së njohjes një çift nuk resht së foluri. Bisedat janë të gjata, plot intensitet e larmi dhe të mbushura me kërshtëri e me një dëshirë për të hapur tema interesante.

Fatkeqësisht, rëndom ndodh që pas martesë cilësia e bashkëbisedimit bie ndjeshëm, pasi çifti ka konsumuar kaq shumë biseda, dhe bien në një gjendje “gjumi”, ku secili përfshihet në gjëra të cilat u marrin kohën dhe vëmendjen. Bashkëshorti vjen nga puna i lodhur dhe mendon të ulet e të shohë lajmet apo të lexojë gazetën sportive me dëshirën për t’u çlodhur. Gruaja, nga ana e saj, mezi pret që bashkëshorti të kthehet nga puna e të bisedojë me të sesa të bukura qenë këpucët e nuses së kushëririt të saj të dytë, e cila ka hapur një dyqan shumë të bukur në qytet.

Ai: i lodhur nga bisedat e ditës në

punë pret që të bjerë rehat në shtëpi, duke mos folur e duke mos iu përgjigjur askujt. Nuk ka asgjë kundër së shtrenjtës së tij, por ja që nuk i flitet më.

Ajo: dëshiron që t'i tregojë atij çdo detaj, qoftë edhe të parëndësishëm, qoftë edhe thjesht sa për të biseduar, pasi ajo ka nevojë që të flasë me dikë. Përse ai nuk ka dëshirë që të flasë më me të? Ai fliste dikur, madje për lloj-lloj gjërash.

Bisedat e një femre vërtiten rreth ngjarjeve të ditës së saj, rreth njerëzve që ajo ka takuar, rreth ndjesive që ata i kanë shkaktuar. Ajo ka nevojë që dikush tjetër të jetë pranë saj, jo vetëm për ta dëgjuar, por edhe për ta shoqëruar në ndjesitë e saj. Kur kjo gjë ndodh, ajo ndihet shumë mirë dhe e afërt me atë person.

Kur bashkëshortët nuk janë "veshi i hapur" për të bashkëbiseduar, femrat ndihen keq. Sidomos kur ata heshtin me ty dhe "iu zgjidhet gjuha" me miqtë e tyre, duke bërë biseda nga më boshet (sipas mendimit tënd).

Nëse një çift dëshiron që ta mbajë marrëdhënien apo martesën të shëndetshme, duhet të mendojë me shumë kujdes për përmbushjen e nevojave të njëri-tjetrit. Nuk mund të bisedosh nëse nuk ke kohë për bisedë.

Tregohuni të kujdesshëm që çdo ditë të keni një sasi kohe të mjaftueshme për të bashkëbiseduar rreth punës, ndjesive, sfidave, shqetësimeve apo edhe ndaj gjërave që juve ju duken të parëndësishme, por që e dini shumë mirë se janë të rëndësishme për bashkëshorten tuaj.

Grave iu pëlqen shumë që gjatë ditës të marrin ndonjë telefonatë apo ndonjë mesazh prej jush. Mos ua privoni këtë kënaqësi!

Folëm në fillim të këtij shkrimi se si gjatë periudhës së njohjes një çift shijon biseda të mrekullueshme. Po ta mbani mend, gjithsekush nga ne ka pasur dëshirë për ta njohur tjetrin sa më mirë dhe për t'i rrëfyer se sa shumë kujdesemi për të. Kini kujdes që të mos e humbisni këtë ndjesi, pasi një marrëdhënie dashurie duhet mbajtur në jetë, ajo nuk mbetet e njëjta pa treguar kujdes për të.

Burrat, duke anashkaluar këtë nevojë të rëndësishme të grave, u japin atyre mesazhe të gabuara, si: mosintere-

simi, indiferenca apo edhe mungesa e dashurisë.

Shumë raste të tradhtive bashkëshortore kanë filluar thjesht sepse grujat ka gjetur dikë i cili e dëgjon atë me ëndje apo edhe bisedon me të, krejt ndryshe nga burri i saj, i cili i ka mbaruar të gjitha temat e bisedave me të.

Pa bashkëbisedim të përditshëm 'nuk mund të mbahet në këmbë' një marrëdhënie e ngrohtë dashurie dhe një marrëdhënie intime e shëndetshme, për të cilat kanë nevojë partnerët.

Ekzistojnë disa "përbindësja" të cilët e "mbysin" bashkëbisedimin në çift:

1. Kryerja e bisedave për të ndëshkuar tjetrin. Ka çifte që gjatë një bisede përdorin nofka për t'iu drejtuar njëri-tjetrit. Nuk dihet se nga ku nxjerrin epitete fyese dhe i kundërvihen çdo gjëje të mirë që kanë së bashku.

2. Biseda ku tjetrit i imponohet një opinion me çdo kusht. Këto janë biseda shumë të pakëndshme, ku palët nuk kuptohen, sepse njëri nuk arrin të kuptojë mendimin e tjetrit, duke kërkuar që tjetri të bjerë dakord, qoftë edhe kundër dëshirës së vet.

3. Përsëritja e gabimeve të së shkuarës, duke kujtuar episode të pakëndshme dhe dështime në çaste të vështira, duke tallur e duke ulur njeriun e shtrenjtë e të dashur, për të cilin je betuar se do t'i qëndrosh pranë deri në vdekje.

Për çfarë mund të bisedoni me njëri-tjetrin?

Për gjëra nga më të ndryshmet, duke filluar që nga ditët tejet të nxehta e deri tek Xhokoviçi, kampioni më i ri i tenisit për meshkuj, nga kriza ekonomike greke deri tek ngjyrat që janë në modë në këtë sezon, nga dhëmbët e parë të foshnjës suaj deri tek tensioni i tezes nga babai. Mos kini drojë të bisedoni për sfidat dhe frikërat tuaja. Femrat ndiejnë shumë siguri kur flasin për gjërat sfiduese me bashkëshortët e tyre. Shpeshherë unë i kërkoj mendim bashkëshortit tim të duruar edhe për detaje që për meshkujt nuk kanë kurrfarë rëndësie, por ideja që ai më ka dëgjuar, më bën me krahë dhe ma lehtëson vendimmarrjen.

Indiferenca dhe mungesa e komunikimit çon drejt thellimit të hapësirave ndarëse dhe femrat bëhen të ashpra dhe

Nëse një çift dëshiron që ta mbajë marrëdhënien apo martesën të shëndetshme, duhet të mendojë me shumë kujdes për përmbushjen e nevojave të njëri-tjetrit.



cinike shumë lehtë, ndërsa meshkujt të pandjeshëm.

Uroj që të keni dëshirë për të përmbushur nevojat e njëri-tjetrit me një zemër të dashur, përulësi e mirësi!

Ndërsa ju jetoni jetën tuaj në çift, nëse keni fëmijë, ju po modeloni edhe një rol të rëndësishëm përpara tyre. Kujdes se çfarë modeloni!



Dashamirësisht,
Edi Gogu
Lëvizja
"PROFAMILJA"



*“A pranon ti ... të marrësh
si bashkëshorte...”*

*Ta duash e ta respektosh në
të mirë e në të keq*

*Në pasuri e varfëri, në
shëndet e sëmundje*

Deri sa vdekja t’ju ndajë?”

Derisa vdekja të na



Këto fjalë përcillnin tek unë një ndjenjë të fortë gëzimi dhe një imazh dashurie të pastër.

Gjyshërit e mi u detyruan të braktisin vendin e tyre, Çamërinë, në 1944 për shkak të gjenocidit mbi këtë popullsi. Ata e ndërtuan me shumë mund jetën këtu. U rrita në një familje me parime të forta. Prindërit e mi punuan e luftuan fort për të arritur nga hiçi këtu ku janë sot. U shkolluan mes varfërisë së tejskajshme, gjë që nuk i kushtëzoi të bënin një jetë të ndershme e që kërkuan me gjithë forcë të na e mësonin edhe ne fëmijëve. Shprehja “Nuk e bëj dot” sipas tyre nuk duhej të ekzistonte. Ishin shumë autoritarë dhe ndonjëherë kërkonin shumë nga ne. Na mbetej t’u bindeshim e ndonjëherë me shumë përpjekje të arrinim deri në fund.

Gjyshërit e mi agjëronin në fshehtësi, gjë që sipas tyre ishte e mirë të bëhej për Zotin. Në perceptimin tim Zoti ishte i madh, i tmerrshëm, ndëshkues, digjte në zjarr të përjetshëm të gjithë ata që gabonin, gjë që përcaktohej pas vdekjes fizike, kur njerëzit kalonin mbi

një urë sipër një liqeni të madh zjarri, e cila bëhej sa një fije floku për mëkatarët. Kjo gjë më trembte shumë. Kësaj pamjeje tronditëse të besimit i bashkoheshin dhe histori të frikshme e besëtytni rreth shpirtave e xhindeve, që ndodheshin kudo e kushtëzonin jetën e njeriut. Ndërsa rritesha, frika ndaj Zotit, frika e bërjes së gabimeve, të ndjekura nga ndëshkimi i prindërve që kërkonin përsosmëri për të ruajtur imazhin në komunitet, u bënë pjesë e jetës sime.

Me dëshirën dhe zgjedhjen e prindërve në moshën 14-vjeçare vazhdova studimet larg shtëpisë. U vendosa në konvikt. Ishte koha të përballesha me një realitet të ri. U gjenda mes rreziqesh që nuk munda t’i identifikoja menjëherë për shkak të naivitetit të moshës. Fillova pak nga pak të mos përmbushja standardet e kërkua nga prindërit. Rashë nga mësimet, fillova cigaren, lija orët e mësimet, shkoja në disko dhe shpesh kam qenë e ekspozuar ndaj rrezikut të drogës. Mësuesit na shihnin me përçmim në konviktoret. Shoqëroheshja me vajza që nuk kishin

opinion të mirë, por ishin të vetmet me të cilat ndihesha e pranuar. Fillimisht më vriste ndërgjegjja për mënyrën se si po sillesha ndaj prindërve, më pas e vlerësova si një formë ndëshkimi ndaj tyre dhe liri ndaj vetes.

Vazhdova ta kërkoj Zotin në mënyra të ndryshme: provova të agjëroj, mësova nga halla ime të yshtja për të larguar syrin e keq, shfaqta interes ndaj budizmit, u kërkova dy shoqeve të dhomës të më mësonin si të lutesha. Shpeshherë i lutesha Zotit si dija vetë, duke i shfaqur dëshira të ndryshme. Nuk merrja përgjigje, të cilat i kërkoja më pas në falle letrash, filxhanësh, horoskop. Kisha në shpirt një boshllëk që kërkoja ta mbushja, por Zoti nuk përgjigjej, ndërsa pyetjet vazhdonin të më mundonin.

Pas shkollës së mesme u ktheva në shtëpi. U bëra rebele ndaj prindërve, të cilët ishin të zhgënjyer ndaj meje dhe ruanim rastin për të zbrazur inatin e mllefim ndaj njëri-tjetrit. Situata shkonte deri edhe në të goditura ndaj meje, por isha kokëfortë e nuk hapja rrugë.

ndajë

Kërkoja një mundësi të largohesha nga autoriteti i tyre. Zgjidhja e vetme ishin studimet e larta. Edhe pse prindërit e mi ishin shumë ngushtë ekonomikisht, më lejuan të konkurroja, por nuk e fitova degën e kërkuar dhe nuk pranova asgjë tjetër. Më dukej vetja dështake dhe e paafte për asgjë.

Meqenëse kisha përfunduar një shkollë të mesme profesionale në një nga profilet e arsimit, nëna ime më drejtoi të kërkoja punë në arsim. Fillova punë si edukatore kopshti. Situata ekonomike ishte ende e vështirë dhe nëna ime më lutej të provoja studimet e larta me korrespondencë. Nuk pranova dhe humba kështu edhe një vit tjetër.

Atë verë në qytetin tim erdhi një skuadër e projektit AERO, nga instituti "Jeta e re", për të shfaqur filmin e Jezusit. E ftuar nga një fqinja ime shkoja gjatë pushimit të drekës. Pas një bisede të gjatë, u largova pa optimizëm. Pas kësaj takohesha me fqinjën time, e cila ishte besimtare dhe bëra lutjen e shpëtimit sa për të provuar diçka të re dhe të shihja çfarë do të ndodhte.

Në të njëjtën kohë, një i njohur që sapo kishte hapur një biznes më kërkoi që të punoja në turnin e pasdites si kameriere e do të paguhesha njëlloj si në punën që kisha. Oferta ishte joshëse, paratë na duheshin dhe me miratimin e prindërve fillova punë. Gjërat dukeshin mirë në fillim. Lodhësja, por isha e kënaqur me atë që fitoja. Të punoje si kameriere ishte e vështirë për opinionin, por më qetësonte fakti që punoja me njerëz të panjohur dhe nuk më interesonte nëse do të flisnin keq, gjë që nuk ishte hera e parë.

Në dhjetor të atij viti fitova të drejtën e studimeve në sistemin e korrespondencës. Tashmë që gjithçka dukej e realizuar, do të fillonte periudha më e errët e jetës sime.

Pak nga pak u përfshiva në lidhje me punëdhënësin tim, i cili ishte i martuar dhe me fëmijë. Siç mësova më vonë, kjo lidhje ishte planifikuar nga persona (gruaja e tij, një nip i tij që merrej me trafik klandestinësh dhe armësh) për qëllim trafikimi, pasi ishin të mbytur në borxhe. Punëdhënësi im nuk e kishte problem joshjen, e kishte bërë edhe më parë me gra të martuara. Isha nën pranga. Nuk kisha forcë të dilja prej kësaj marrëdhënieje, edhe pse nuk më pëlqente. Ai kishte planifikuar të më nxirrte një vizë në Ambasadën Italiane dhe të largoheshim për të jetuar gjoja bashkë në Itali, pasi këtu nuk qe e mundur. Për të bindur prindërit që të më linin të largohesha, u thashë se do të qëndroja tek kushërira ime, që ishte studente në Tiranë.

Isha para derës së ambasadës, gati për të hyrë brenda. Kushërira ime erdhi atje duke qarë dhe duke m'u përgjyruar për të më ndaluar. Vendosa të kthehem. Ai mbeti i zhgënjyer dhe pas kësaj nuk shfaqti më asnjë shenjë interesi ndaj meje. Historia ime u përfol në komunitet dhe bëri bujë në një kohë të shkurtër. Pa kaluar shumë kohë, ai u largua jashtë Shqipërisë me familjen e tij.

Unë mbeta atje për t'u përballur me gjithçka: opinionet, paragjykimet, talljet, mendimet që isha një vajzë me të cilën çdokush mund të bënte ç'të donte, qëndrimin përçmues të prindërve, ofertat nga më përlulëse të meshkujve. Unë mbeta aty pa askënd, por me një Dhiatë të Re. Pashë se sa shumë kisha

përdhosur atë që ëndërroja të ndodhte një ditë në jetën time e që më tërhiqte kaq shumë nga krishterimi - martesën me ceremoninë e saj.

E ndieja veten të ndyrë. Më shumë se kurrë tani kisha nevojë për mëshirë, hir, dashuri, që ia kërkoja Zotit. Ai më foli me fjalë nga I Kor. 1:27, Mat. 11:28, "...Por Perëndia ka zgjedhur gjërat e marra të botës për të turpëruar të urtët, dhe Perëndia ka zgjedhur gjërat e dobëta të botës për të turpëruar të fortët..."

"...Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar e të rënduar, e unë do t'ju jap çlodhje."

Që nga ai çast, fillova një jetë të re me Zotin. E falur! Për prindërit e mi tashmë isha bërë edhe "kaure", njëlloj si armiqtë që kishin masakruar e përzënë të parët e mi nga vendi i tyre. Kjo ishte pamja që të mitë kishin për krishterimin. Pavarësisht vështirësive, ia besova zemrën time Zotit, gjithë mendimet e mia të fshehta, dëshirat e zemrës. Ai është treguar gjithnjë besnik. Ai më ndryshoi, ndryshoi situatën time. Perëndia e ndryshoi jetën time, duke bërë që njerëzit dhe opinionin që më kishte gjykuar për vdekje të më vlerësonte e të më respektonte. Pas pak vitesh, Zoti më nderoi duke më bekuar me një bashkëshort që beson te Perëndia. Me të sot po përjetojmë bekimin e asaj martese që ishte ëndrra ime nga fillimi!

Nuk do të arrij kurrë t'i jem mirënjohëse sa duhet Perëndisë, Atit tim dhe duke qenë se sytë e mi e kanë parë madhësitinë e Tij, nuk do të resht së foluri për Të.



Nënshtrimi

NË MARTESË

Pjesa e dytë

Është thënë nga shumë shkrimtarë përgjatë viteve që një e vërtetë shumë e rëndësishme është se gruaja që dashurohet vërtet, së cilës i ofrohet përkujdesje dhe që pëlqehet nga bashkëshorti i saj nuk do ta ketë të vështirë t'i nënshtrohet udhëheqësisë së tij! Një fjalë për burrat këtu – Shkrimet ju urdhërojnë ta doni gruan tuaj si Krishti deshi kishën, duke e dhënë veten për TË! Kjo është një shprehje e skajshme devotshmërie! Burri duhet të përkushtohet për të kërkuar të mirën për gruan e tij! Është përgjegjësia juaj dhënë nga Perëndia për të modeluar udhëheqësi joegoiste dhe të ndjeshme, që do të konsolidojë familjen dhe do t'i japë dinjitet dhe nderim gruas suaj. Kur një burrë jeton në këtë lloj nënshtrimi ndaj Perëndisë, edhe gruaja e tij si këmbim do të jetë bashkëpunuese dhe e hirshme ndaj tij. Është një marrëdhënie e ndërsjellë, gjithmonë duke dhënë dhe duke marrë.

A mund t'ju bëj dy pyetje tani? Burra, a i doni gratë tuaja aq shumë sa të jepni jetën për to? Gra, a i doni aq shumë burrat tuaj sa ta jetoni jetën për ta?

Burri dhe gruaja duhet të mësojnë të jetojnë me njëri-tjetrin. Kjo do të thotë të ndihen plotësisht rehat me njëri-tjetrin. Bëjeni marrëdhënien tuaj

përparësi. Jetoni duke e njohur njëri-tjetrin me të vërtetë. Kjo në fakt kërkon gjithë jetën. Zbuloni se cilat janë mendimet më të thella të bashkëshortit/es suaj, shpresat e tij/e saj, frikërat, lëndimet. Mëso se për çfarë ai/ajo ka nevojë që të jetë i/e sigurt dhe pastaj jepjani atë inkurajim bashkëshortit/es suaj. Burrat dhe gratë kanë nevoja, ndjenja, ëndrra të ndryshme. Ata e shohin jetën, mjaft shpesh, nga perspektiva të ndryshme. Prandaj përcaktoni kohë për ta njohur njëri-tjetrin më thellë dhe mbani mend: respektoni ato dallime!

Kjo më sjell mua te një fjalë të cilën ju ndoshta nuk prisni ta gjeni në një artikull mbi nënshtrimin. Është fjala e shkurtër “hir”.

Hiri është i nevojshëm që ne të pranojmë rolet tona personale dhe unike brenda marrëdhënies martesore. Gruaja mund të mos “ndihet” gjithmonë e gatshme të nënshtrohet, të respektojë vendimet e tij etj., por “hir” do të thotë që ne e bëjmë këtë gjë nga dashuria për Zotin dhe bashkëshortin tonë. Burri mund të mos “ndihet” gjithmonë i gatshëm të dojë ose madje të dëshirojë ta trajtojë mirë dhe të përkujdeset me dashuri për gruan e tij, por “hir” do të thotë që ai e bën këtë nga dashuria që ka për Zotin dhe për bashkëshorten e tij.

Hiqeni fjalën “në qoftë se” nga fjalori juaj! Ne duhet ta duam njëri-tjetrin pa vendosur kushte! Mësoni t'i nënshtroni “po nëse-të” dhe “po, por-et” tuaja! Provat zakonisht vijnë në “gjërat e vogla” kur ne duam automatikisht të shprehim parapëlqimet apo argumentet tona! Më lejoni të jap një ilustrim vetjak për këtë. Kur u shpërngula për herë të parë në Gjirokastër në trazirat e vitit 1997, shumica e plaçkave të mia vetjake u vdhën. Ndërmjet tyre ishte një komplet tenxheresh dhe tiganësh, që unë i kisha sjellë me vete në Shqipëri. Një vit e gjysmë më pas, kur ne ishim të martuar dhe po bashkonim dy shtëpi në një, unë shpreha dëshirën që të blinim një komplet të ri tiganësh dhe tenxheresh. Bashkëshorti im kishte tenxhere dhe tiganë të vjetër, që nuk formonin një komplet! Ai më tha se ato që ai kishte ishin të përdorshme dhe që nuk kishim pse të shpenzonim lekë për një komplet të ri! Kjo ishte pak stresuese, por unë e pranova vendimin e tij! Ashtu si sapo thashë pak më lart, beteja shpesh vjen nga ato gjëra të vogla në jetë në të cilat ne vihemi në provë. Meqë ra fjala, tenxheret dhe tiganët janë ende në përdorim, megjithëse kemi shtuar të tjera pak nga pak!

Krenaria do të na pengojë shpesh për të pasur një qëndrim me respekt dhe nënshttrim. Pa pasur një qëndrim me përlulesi të perëndishme, ne nuk do

Burra, a i doni gratë tuaja aq shumë sa të jepni jetën për to? Gra, a i doni aq shumë burrat tuaj, sa ta jetoni jetën për ta?

të jemi në gjendje të nënshtrohemi si duhet.

Hiri dashuron dhe shërben. Hiri jep dhe fal. Hiri të bën të lirë dhe të jep siguri. Hiri përkrah dhe inkurajon. Hiri e ndërton personin tjetër në vend që ta shkatërrojë¹.

Në kapitullin e dytë të Letrës së Parë të Pjetrit flitet për nënshttrimin ndaj autoritetit: qoftë ndaj qeveritarëve, qoftë ndaj punëdhënësve tuaj, dhe nënshttrimin e Krishtit ndaj vullnetit të Atit të Tij. Kapitulli tre fillon me këto fjalë: “Gjithashtu dhe ju, gra, nënshtrojuuni burrave tuaj.” 1 Pjetrit 3:1-7 është një pasazh i fuqishëm për ne gratë!

Vargu 1 lexohet kështu: “Gjithashtu dhe ju, gra, nënshtrojuuni burrave tuaj, që, edhe nëse disa nuk i binden fjalës, të fitohen pa fjalë nga sjellja e grave të tyre.”

Ndoshta dikush që po e lexon këtë sot gjendet në një martesë ku ju jeni besimtare, por bashkëshorti juaj nuk është. Ndoshta ju jeni duke hasur vështirësi për të kaluar kohë me besimtarë të krishterë për shkak të kësaj, ose shumë sfida të tjera. Shumë vite më parë unë kam lexuar një dëshmi të jashtëzakonshme, që e ilustron bukur të vërtetën e fuqishme të këtij vargu.

Kjo grua erdhi në besim te Krishti dhe filloi të frekuentonte një kishë lokale në vendin ku jetonin. Bashkëshorti i saj nuk besoi si ajo, por megjithatë ai e lejoi që të shkonte në kishë, edhe pse ai vetë nuk shkonte kurrë. Erdhi koha

kur gratë në kishën e saj do të shkolin në një konferencë për një fundjavë. Edhe ajo kishte shumë dëshirë të shkonte. Shkoi në shtëpi dhe, kur iu dha mundësia, ajo e hapi këtë bisedë duke e pyetur të shoqin nëse ai do ta lejonte të largohej për pak ditë, për të shkuar në konferencën biblike. Ajo u bëfashua kur ai i tha hapur se nuk donte që ajo të shkonte dhe i kërkoi të qëndronte në shtëpi! Menjëherë filloi një betejë e fortë në zemrën e kësaj gruaje. A duhet t'i bindej të shoqit apo të vendoste të shkonte në konferencë kundër dëshirës së tij? Ajo u lut dhe mori vendimin t'i nënshtrohej vendimit të burrit të saj, pavarësisht nga zhgënjimi i thellë që nuk do të ishte me mikeshat e saj të krishtera. Ajo zgjodhi të mos sillej si e mërzitur apo si e inatosur, që t'i tregonte atij që ndihej ashtu, por të vazhdonte të ishte një grua e dashur dhe që ia donte të mirën. Historia pastaj vazhdon nga dy vite më vonë. Ajo dhe i shoqi (i cili tashmë ishte bërë besimtar) po merrnin pjesë së bashku në një konferencë për çiftet për herë të parë! Gjatë mbrëmjes së parë bashkëshorti i kësaj gruaje u ngrit në këmbë dhe doli përpara të tjerëve. Me lot në sy ai tha këtë: “Jam sonte këtu për shkak të një zgjedhjeje që gruaja ime bëri kur i kërkova të mos shkonte në një konferencë ku ajo donte vërtet të shkonte. Ajo më fitoi mua me sjelljen e saj të perëndishme, jo vetëm me fjalët e saj. Ajo u nënshtroi në një mënyrë aq të hirshme, të urtë, sa që unë fillova të pyesja veten se çfarë ishte ajo gjë që e bënte atë të sillej në atë mënyrë. Unë zbulova që ishte Krishti brenda

saj. Ajo kishte bukurinë e një fryme të butë dhe të qetë. Unë gjithashtu gjeta Krishtin për shkak të të jetuarit të saj si Krishti.” Nuk mbeti asnjë sy pa u përbotur në sallë.

E reflektoshim edhe ne kaq bukur Krishtin në ecjen tonë, që të mund t'i fitojmë edhe ne ata që janë më të afërtit dhe më të dashurit për ne!

Është roli dhe privilegji ynë të modelojmë këto tipare të karakterit femëror, që janë të çmuara për Perëndinë dhe të rëndësishme për bashkëshortët tanë. Perëndia e nderon këtë. Fjalët e Urta 12:4 deklarohen këtë të vërtetë: “Gruaja e virtytshme është kurora e burrit të vet, por ajo që e turpëron është si një krimb në kockat e tij.” Fitojeni bashkëshortin tuaj me mirësi. Kjo nuk është një nxitje vetëm për ato që i kanë bashkëshortët jo të krishterë. Kjo është e vërtetë për secilën nga ne. Një gjë themelore për të pasur një martesë të perëndishme është kjo bukuri e brendshme e karakterit, për të cilën flet Bibla. Le të shohë bashkëshorti juaj dhe të tjerët te ju bukurinë e pavenitur të një fryme të butë dhe të qetë, të pastërtisë morale dhe bukurinë, burimi i së cilës është Krishti brenda nesh.

1. Mendime të mbledhura nga një mesazh i Çarls Suindollit (Charles Swindoll).

Përktheu Rudina Boçe



NJË BURRË U KTHYE NË SHTËPI PAS PUNË DHE...

Një burrë u kthye në shtëpi pas pune dhe i gjeti tre fëmijët përjashta, akoma me pizhama, duke luajtur në baltë me kuti ushqimore të boshatisura dhe letër ambalazhi të përhapur nëpër gjithë oborrin e përparmë. Dera e makinës së gruas ishte e hapur, e po ashtu edhe dera e përparme e shtëpisë. Qeni nuk dukej askund.

Duke u futur brenda, gjeti rrëmujë edhe më të madhe. Një llambë ishte rrëzuar dhe qilimi ishte ngjeshur pas një muri. Në sallon, televizori ishte në kupë të qiellit tek një kanal filmash vizatimorë dhe dhoma e ndenjies ishte plot me lodra dhe rroba të ndryshme.

Në kuzhinë, lavamani ishte plot enë, ushqimi i mëngjesit ishte derdhur në banak, dera e frigoriferit ishte plotësisht e hapur, ushqimi i qenit ishte derdhur mbi dysheme, një gotë e thyer gjendej poshtë tavolinës dhe një grumbull i vogël me dhë ishte pranë derës së mbrapme.

Iu ngjit shkallëve me shpejtësi, duke shkelur mbi lodra dhe turra të tjera me rroba, në kërkim të së shoqes. Ai ishte në merak se mos

ishte e sëmurë, ose kishte ndodhur diçka e rëndë. E priti një curril i hollë uji që dilte poshtë derës së banjës.

Kur hodhi një sy brenda, pa peshqirë të lagur, sapun të bërë shkumë dhe lodra të tjera të përhapura gjithandej nëpër dysheme. Kilometra letre higjienike ishin bërë grumbull dhe pasta e dhëmbëve kishin njollosur pasqyrën dhe muret.

Kur nxitoi drejt dhomës së

gjumit, e gjeti gruan akoma në krevat me pizhama, duke lexuar një roman. Ajo ngriti sytë drejt tij, i buzëqeshi dhe e pyeti si i kishte shkuar dita. Ai e pa i habitur dhe e pyeti: "Çfarë ka ndodhur sot këtu?"

Ajo buzëqeshi sërish dhe u përgjigj: "A më pyet çdo ditë kur kthehesh në shtëpi çfarë bërë gjithë ditën e ditës?"

"Po", - u përgjigj ai, akoma pa u besuar syje.

Ajo iu përgjigj: "Epo, pikërisht ato gjëra nuk i bëra sot."



A ju kujtohet historia e Simonit dhe e Ruthit nga artikulli i numrit të kaluar të revistës Ilira? Ata vendosën të eksperimentonin, duke kryer marrëdhënie seksuale përpara se fejesa e tyre të bëhej zyrtare. Ata donin të provonin nëse “përputheshin” me njëri-tjetrin. Kjo natë e marrëdhënies së tyre të fshehtë rezultoi në një katastrofë, gjë që çoi edhe në ndarjen e tyre. Secili prej tyre ishte i bindur që kjo “provë” kishte qenë e domosdoshme, meqenëse kishin zbuluar tek njëri-tjetri gjëra që nuk i pëlqenin. Cili është mendimi juaj në lidhje me eksperimentin, apo edhe me përfundimin?

Copëza e parë e këshillës që ne do t'i ofronim një çifti të ri në këtë situatë është se nuk është e nevojshme të flesh me të dashurin/të dashurën për të zbuluar se si është “nën çarçafë”. Partneri/ja juaj ashtu siç është jashtë dhomës së gjumit, ashtu do të jetë edhe në dhomën e gjumit. Për shembull, nëse është i sjellshëm, vetësakrifikues dhe i durueshëm gjatë ditës, ai/ajo do të jetë po ashtu një partner/e i sjellshëm, vetësakrifikues dhe i durueshëm gjatë një nate pasioni. Njerëzit nuk e ndryshojnë karakterin me rrobat e tyre! Të qenët i/e dashur i mrekullueshëm ka lidhje më tepër me karakterin e një njeriu sesa me teknikën; prandaj ne duhet të presim që të krishterët të jenë të dashurit/të dashurat më të mirë. Në nivelin fizik, Perëndia e ka pajisur trupin e burrit/gruas në atë mënyrë që të ketë marrëdhënie seksuale, prandaj nuk ka shumë gjasa që të ketë problem me këtë lloj “përputhshmërie” dhe si pasojë nuk ka nevojë për të bërë një “provë” përpara martesës.

Meqë ra fjala, arsyeja se përse marrëdhënia e Ruthit dhe Simonit nuk funksionoi ishte për shkak të stresit shtesë që ata morën mbi vetveten, duke hyrë në marrëdhënie seksuale paramartesore; ky stres zbuloi aspekte të karakterit që ishin shumë të papërshtatshme. Gjithsesi, ka shumë mundësi që do t'i kishin zbuluar ato dobësi në rrethana të tjera herët a vonë. Eksperimentimi seksual është një aktivitet me rrezik dhe delikat, dhe kjo është arsyeja përse Perëndia ynë i dashur e ruan brenda besëlidhjes së martesës, gjë që është diçka shumë

më e fuqishme dhe jetëgjatë sesa akti seksual.

Shkurajimi që ne i bëjmë marrëdhënies seksuale paramartesore zakonisht ngre një pyetje tjetër: “Sa larg mund të shkojmë në intimitet para fejesës?”. Bibla flet shumë në lidhje me qëndrimet dhe mendimet rreth kësaj gjëje. Për shembull 2 Timoteu 2:22 (NLT): ‘*Arratisju pasioneve rinore dhe bjeru pas drejtësisë, besimit, dashurisë dhe paqes bashkë me ata që e thërrasin emrin e Zotit me zemër të pastër*’. Prandaj ne duhet të shmangim të vendosurit e vetes në situata që mund të mbistimulojnë dëshirat tona fizike në një fazë të hershme të marrëdhënies. Ka disa çifte, të cilat nuk duan të kryejnë marrëdhënie seksuale para natës së tyre të parë të martesës, por prapëseprapë ata bëhen fizikisht kaq të përfshirë sa t'i thonë ‘jo’ marrëdhënies seksuale bëhet shumë e vështirë dhe stresuese. Është sikur të ngasësh një makinë me shpejtësi drejt semaforit, duke shpresuar që të ndalosh me frena fuqimisht në çastin e fundit. Natyrisht nuk e bën udhëtimin të rehatshëm! Nuk është e ndershme ndaj partnerit apo vetvetes. Kultura të ndryshme e shohin periudhën e fejesës në mënyra të ndryshme, por ka gjithnjë një linjë praktike që të gjitha çiftet duhet ta ndjekin: nëse nuk jeni duke planifikuar që të martoheni për shembull për 6 muaj, atëherë nuk duhet të ndërtoni nivele të intimitetit fizik tepër shpejt para natës së parë të martesës.

Është shumë më mirë të përqendrohemi tek komunikimi në një nivel intelektual, shpirtëror dhe emocional, duke u përfshirë në shumë biseda, të shkruani letra ose e-maile, sesa t'u lejoni tepër liri duarve që të “bisedojnë”. Çiftet që e lejojnë anën fizike të marrëdhënies të përparojë më shpejt sesa këto aspekte të tjera të marrëdhënies shpesh do të gjejnë që kanë shumë pak gjëra të përbashkëta përveç pasionit për njëri-tjetrin, i cili vjen duke u zvogëluar gjatë martesës. Periudha e fejesës është një kohë e dhënë nga Perëndia për të mësuar për njëri-tjetrin, duke rrëfyer mendimet, idetë dhe vizionet, të cilat mund të mos keni kohë për t'ia treguar njëri-tjetrit sapo të martoheni; është një kohë e thellë formuese dhe e çmuar.

Çfarë ndodh nëse kemi shkuar “tepër larg”?

Po nëse një çift i krishterë, që ka ndër mend të martohet, është përfshirë nga pasioni dhe ka kryer marrëdhënie seksuale paramartesore? Çfarë duhet të bëjnë? Cili është reagimi i kishës?

Së pari, na lejoni t'i kujtojmë vetvetes se Bibla është për jetën e krishterë. Nuk është një libër ligji, ku shkelja më e vogël e shkualifikon dikë nga çdo marrëdhënie e ardhshme me Perëndinë, por më tepër i drejton rrugën për tek Jezusi, Shpëtimtari dhe mënyra e shpëtimit. Të jesh një njeri me një sjellje të mirë, nuk është një rrugë që të drejton në jetën e përjetshme dhe prandaj as sjellja

MARRËDHËNIA SEKSUALE PARA E drejtë apo e gabuar?

A ju kujtohet historia e Simonit dhe e Ruthit nga artikulli i numrit të kaluar të revistës Ilira? Ata vendosën të eksperimentonin, duke kryer marrëdhënie seksuale përpara se fejesa e tyre të bëhej zyrtare. Ata donin të provonin nëse “përputheshin” me njëri-tjetrin. Kjo natë e marrëdhënies së tyre të fshehtë rezultoi në një katastrofë, gjë që çoi edhe në ndarjen e tyre. Secili prej tyre ishte i bindur që kjo “provë” kishte qenë e domosdoshme, meqenëse kishin zbuluar tek njëri-tjetri gjëra që nuk i pëlqenin. Cili është mendimi juaj në lidhje me eksperimentin, apo edhe me përfundimin?

Copëza e parë e këshillës që ne do t'i ofronim një çifti të ri në këtë situatë është se nuk është e nevojshme të flesh me të dashurin/të dashurën për të zbuluar se si është “nën çarçafë”. Partneri/ja juaj ashtu siç është jashtë dhomës së gjumit, ashtu do të jetë edhe në dhomën e gjumit. Për shembull, nëse është i sjellshëm, vetësakrifikues dhe i durueshëm gjatë ditës, ai/ajo do të jetë po ashtu një partner/e i sjellshëm, vetësakrifikues dhe i durueshëm gjatë një nate pasioni. Njerëzit nuk e ndryshojnë karakterin me rrobat e tyre! Të qenët i/e dashur i mrekullueshëm ka lidhje më tepër me karakterin e një njeriu sesa me teknikën; prandaj ne duhet të presim që të krishterët të jenë të dashurit/të dashurat më të mirë. Në nivelin fizik, Perëndia e ka pajisur trupin e burrit/gruas në atë mënyrë që të ketë marrëdhënie seksuale, prandaj nuk ka shumë gjasa që të ketë problem me këtë lloj “përputhshmërie” dhe si pasojë nuk ka nevojë për të bërë një “provë” përpara martesës.

Meqë ra fjala, arsyeja se përse marrëdhënia e Ruthit dhe Simonit nuk funksionoi ishte për shkak të stresit shtesë që ata morën mbi vetveten, duke hyrë në marrëdhënie seksuale paramartesore; ky stres zbuloi aspekte të karakterit që ishin shumë të papërshtatshme. Gjithsesi, ka shumë mundësi që do t'i kishin zbuluar ato dobësi në rrethana të tjera herët a vonë. Eksperimentimi seksual është një aktivitet me rrezik dhe delikat, dhe kjo është arsyeja përse Perëndia ynë i dashur e ruan brenda besëlidhjes së martesës, gjë që është diçka shumë



MARRËDHËNIA SEKSUALE PARA MARTESORE: E drejtë apo e gabuar? (PJESA E DYTË)

më e fuqishme dhe jetëgjatë sesa akti seksual.

Shkurajimi që ne i bëjmë marrëdhënies seksuale paramartesore zakonisht ngre një pyetje tjetër: “Sa larg mund të shkojmë në intimitet para fejesës?”. Bibla flet shumë në lidhje me qëndrimet dhe mendimet rreth kësaj gjëje. Për shembull 2 Timoteu 2:22 (NLT): ‘*Arratisju pasioneve rinore dhe bjeru pas drejtësisë, besimit, dashurisë dhe paqes bashkë me ata që e thërrasin emrin e Zotit me zemër të pastër*’. Prandaj ne duhet të shmangim të vendosurit e vetes në situata që mund të mbistimulojnë dëshirat tona fizike në një fazë të hershme të marrëdhënies. Ka disa çifte, të cilat nuk duan të kryejnë marrëdhënie seksuale para natës së tyre të parë të martesës, por prapëseprapë ata bëhen fizikisht kaq të përfshirë sa t'i thonë ‘jo’ marrëdhënies seksuale bëhet shumë e vështirë dhe stresuese. Është sikur të ngasësh një makinë me shpejtësi drejt semaforit, duke shpresuar që të ndalosh me frena fuqimisht në çastin e fundit. Natyrisht nuk e bën udhëtimin të rehatshëm! Nuk është e ndershme ndaj partnerit apo vetvetes. Kultura të ndryshme e shohin periudhën e fejesës në mënyra të ndryshme, por ka gjithnjë një linjë praktike që të gjitha çiftet duhet ta ndjekin: nëse nuk jeni duke planifikuar që të martoheni për shembull për 6 muaj, atëherë nuk duhet të ndërtoni nivele të intimitetit fizik tepër shpejt para natës së parë të martesës.

Është shumë më mirë të përqendrohemi tek komunikimi në një nivel intelektual, shpirtëror dhe emocional, duke u përfshirë në shumë biseda, të shkruani letra ose e-maile, sesa t'u lejoni tepër liri duarve që të “bisedojnë”! Çiftet që e lejojnë anën fizike të marrëdhënies të përparojë më shpejt sesa këto aspekte të tjera të marrëdhënies shpesh do të gjejnë që kanë shumë pak gjëra të përbashkëta përveç pasionit për njëri-tjetrin, i cili vjen duke u zvogëluar gjatë martesës. Periudha e fejesës është një kohë e dhënë nga Perëndia për të mësuar për njëri-tjetrin, duke rrëfyer mendimet, idetë dhe vizionet, të cilat mund të mos keni kohë për t'ia treguar njëri-tjetrit sapo të martoheni; është një kohë e thellë formuese dhe e çmuar.

Çfarë ndodh nëse kemi shkuar “tepër larg”?

Po nëse një çift i krishterë, që ka ndër mend të martohet, është përfshirë nga pasioni dhe ka kryer marrëdhënie seksuale paramartesore? Çfarë duhet të bëjnë? Cili është reagimi i kishës?

Së pari, na lejoni t'i kujtojmë vetvetes se Bibla është për jetën e krishterë. Nuk është një libër ligji, ku shkelja më e vogël e shkualifikon dikë nga çdo marrëdhënie e ardhshme me Perëndinë, por më tepër i drejton rrugën për tek Jezusi, Shpëtimtari dhe mënyra e shpëtimit. Të jesh një njeri me një sjellje të mirë, nuk është një rrugë që të drejton në jetën e përjetshme dhe prandaj as sjellja

e keqe nuk të shkualifikon për jetën e përjetshme. Vetë Jezusi është dera drejt qiellit, duke besuar në Të, duke iu nënshtruar sundimit të Tij dhe duke besuar në vdekjen dhe ringjalljen e Tij si ndëshkim për mëkatin. Ndaj, urdhërimet për të krishterët që gjenden në Bibël janë për t'i udhëhequr burrin dhe gruan, të cilët qëndrojnë në pozitën: të falur. Efesianëve 5:8-10 thotë: ‘*Sepse dikur ishit errësirë, por tani jeni dritë në Zotin; ecni, pra, si bij të dritës, sepse fryti i Frymës konsiston në gjithçka që është mirësi, drejtësi dhe të vërtetë, duke provuar çfarë është e pranueshme për Perëndinë*’.

Qëllimi ynë, si rrjedhojë, në të hetuarit e Shkrimeve është të zbulojmë se çfarë i pëlqen Perëndisë. Nëse dëshitojmë të bëjmë atë që i pëlqen Atij, atëherë ne mëkatojmë. Nëse ne besojmë se marrëdhënia seksuale jashtë martesës e fyen Atë, dhe prapë vazhdojmë ta bëjmë, atëherë jemi duke mëkatuar. Zgjidhja është e thjeshtë dhe e qartë: kemi nevojë të pendohemi para Perëndisë dhe është detyrimi ynë për faljen e Tij, ashtu siç duhet për çdo mëkat që ne bëjmë; kurvëria nuk është më e rëndë sesa llojet e tjera të mëkateve—thjeshtë është më i dukshëm sesa disa mëkate të tjera. Vetëm sepse shoqëria i konsideron disa veprime më të turpshme sesa të tjerat, nuk do të thotë se Perëndia e konsideron këtë mëkat më të rëndë a më të keq sesa krenaria, zilia, thashethe-

met apo mungesa e përlësisë. Cili nga ne nuk e ka mërziur Perëndinë në një mënyrë a tjetër gjatë javës së shkuar? (Të gjithë ne e kemi bërë këtë gjë!)

Disa çifte të krishtera, të cilat bien në kurvëri, ndihen aq fajtorë dhe të turpëruar, sa imagjinojnë sikur kanë kryer ‘mëkatën e pafalshëm’. Nuk është kështu! Një nga tiparet dalluese të mëkatit të pafalshëm, siç shprehet në Shkrime, është që ata i bëjnë qëndresë Frymës së Shenjtë dhe nuk merakosen aspak për mëkatin e tyre.

Nëse je i shqetësuar për turpin që ndien, duhet të dish që mëkati yt është plotësisht i falshëm dhe ti mund të bëhesh i pastër, një herë e përgjithmonë. Shikoni 1 Gjoni 1:9, 2 Samuelit 12:13 dhe Psalmi 103:12.

Gjëja më e keqe që këto çifte mund të bëjnë është të fshihen nga Zoti dhe nga populli i Tij, për shkak të turpit që ndiejnë. Asnjëherë mos e nënvlerëso fuqinë e faljes dhe hirit e Perëndisë për të fshirë ndëshkimin, fuqinë e mëkatit dhe ta bëjë të pastër ndërgjegjen. Kur mëkati është më i madh, hiri është edhe më i madh (Romakëve 5:20).

Prandaj duhet të kërkonim faljen e Perëndisë dhe gjithashtu të së fejuarës/fejuarit. Sapo ta keni bërë këtë, merreni faljen si një vepër besimi, nëse është e nevojshme.

Pastaj takohuni me një çift të pjekur dhe të besueshëm, drejtues kishë, të cilët janë të martuar, dhe rrëfëjeni këtë para tyre, duke shpjeguar që e keni marrë faljen e Perëndisë dhe jeni pastruar.

Kaloni një kurs këshillimi paramartesor me këtë çift dhe krijoni strategji për të shmangur situata të tundimit seksual para martesës.

Drejtuesit e kishës dhe anëtarët e familjes (nëse janë të krishterë) të të fejuarve duhet të shfaqin hir, në të njëjtën mënyrë si Krishti i ka pranuar. Shikoni 2 Korintasve 2:7-8. Nëse ishte planifikuar një dasmë në kishë, atëherë, sipas nesh, ajo duhet të bëhet. Në fund të fundit, nëse të gjithë njerëzit që mëkatojnë do të përjashtoheshin, kisha do të ishte e zbrazët. Duhet të theksohet se nuk ka detyrim për një çift që ka pasur bashkim fizik që të martohet, edhe nëse ky kurs veprimi është e vetmja rrugë e pranueshme shoqërore, por Perëndia nuk e vë këtë kusht. Dhe le të shmangim përdorimin e shprehive joblike,

si: “Çdo çift që ka kryer marrëdhënie seksuale është i martuar në sytë e Zotit”, sepse nuk është kështu. Çifti vetë mund të vendosë që marrëdhënia e tyre nuk është e drejtë dhe askush nuk duhet t'i detyrojë të martohen në rrethana të tilla, sepse martesë do të dështojë pas disa ditësh.

Lexuesit mund të thonë se po tregohemi shumë shpirtbutë ndaj çiftit që ka rënë në kurvëri dhe kjo e nxit seksin në fejesë. Por edhe apostulli Pal u kritikua se po predikonte një ungjill hiri që fitoi mbi mëkatin—shikoni Romakëve 5:20-21, ndjekur nga Romakët 6. Në fakt, prova që ungjilli po zbatohet si duhet është fakti që natyrshëm lind kjo pyetje e veçantë: “A të mbetemi në mëkat, që të shtohet hiri?” (Përgjigjja. Meqë ra fjala, është “Jo!”). Është paradoksale, por realitet frymëror, se mbushullia e hirit bën që besimtarët ta duan Perëndinë edhe më shumë dhe të përpiqen edhe më shumë t'i pëlqejnë Atij.

Dhe një mendim i fundit në lidhje me beqarët, duke përfshirë këtu ata që nuk janë martuar asnjëherë apo të divorcuarit e të vejat: Mos i kini zët dëshirat seksuale. Janë një dhuratë nga Perëndia dhe pjesë e personalitetit njerëzor. Mësoni t'i kontrolloni dhe të prisni kohën e përsosur të Perëndisë për t'ju drejtuar në martesë, me qëllim që t'i shijoni këto pasione ashtu si Perëndia i ka krijuar. Pak besimtarë janë thirrur për të qenë beqarë. Në këtë rast Ai u jep atyre hir të veçantë për të jetuar jetën prej beqari në një mënyrë të pamëkatë dhe plotësisht të përbushur.

Cilido qofsh ti, shijojë ecjen tënde me Zotin dhe mëso ta nderosh Atë në të gjitha marrëdhëniet e tua. Ata që e nderojnë Atë Ai do t'i nderojë. 1 Samuelit 2:30

Zoti ju bekoftë

Andy dhe Judith (Endi dhe Xhudit) kanë 30 vite martesë, ndër kohë që prej 20 vitesh ata ofrojnë seminare në lidhje me këshillimin martesor. Endi është njëri nga drejtuesit e Vëllazërisë së Krishterë “Thurrok” në Mbretërinë e Bashkuar.

Nëse keni pyetje, ju lutem na shkruani në adresën: revistailira@gmail.com. Ne do të ishim të gëzuar t'ju përgjigjemi. Privatësia juaj do të respektohet!

"Aman dhe ti si je! A nuk ta thashë unë? Sikur ta dija që do të ndodhte kështu të shkretën!"

Fjali plot tension e të mbarsura me inat, që të gjithë i urrejnë t'i dëgjojnë: që nga fëmijët e vegjël, të rriturit e sidomos bashkëshortët, e kjo për faktin se këta njerëz kanë marrëdhënie tepër të ngushta me njëri-tjetrin.

Këto fjalë të sëmbojnë shpirtin dhe japin sinjalin se personi që sapo i ka nxjerrë nga goja ato fjalë ka grumbulluar pakënaqësi, gjykim dhe akuzë në zemrën e vet kundrejt personit të cilit po ia hedh ato qortime.

Çdo ditë ne ndërveprojmë me njëri-tjetrin dhe marrim një numër të madh vendimesh si individë, si bashkëshortë, si prindër. Çfarë ndodh në rastet kur për vendime të rëndësishme ju dhe bashkëshorti/ja juaj nuk keni të njëjtin mendim? Si reagoni kur jeni të acaruar keq me njëri-tjetrin? A pasqyron qëndrimi dhe reagimi juaj karakterin e një burri apo gruaje të perëndishme, ku Krishti është qendra e martesës?

Kol 3:18—*Ju bashkëshorte, jini të nënshtruara bashkëshortëve tuaj, ashtu si ka hije në Zotin. 19—Ju bashkëshortë, duajini bashkëshortet tuaja dhe mos u bëni të ashpër ndaj tyre. 24—duke ditur se nga Zoti do të merrni shpërblimin e trashëgimisë, sepse ju i shërbeni Krishtit, Zotit.*

Duke qenë të rinj në besim, pa pasur një traditë të trashëguar të shembujve të martesave, ku Krishti është qendra e martesave dhe familjeve tona, shumë herë ne reagojmë dhe veprojmë sipas shembujve të huazuar nga librat, apo më keq, nga çfarë na ofron televizioni. Më e bukura është që gjithçka që media na ofron është shumë larg asaj që na mëson Bibla, që të jemi të nënshtruara, të dashura, mbështetëse të bashkëshortëve tanë, pasi duke i bërë të gjitha këto, nderojmë Krishtin. Perëndia na ka thirrur për të jetuar sipas një standardi më të lartë sesa ai që shfaqet në televi-



SI T'INDEROJMË BASHKËSHORTËT NË SY TË FËMIJËVE

zion, në median e shkruar, në tavolinat e kafeneve të panumërta, në lidhje me marrëdhëniet bashkëshortore.

Shpeshherë na ndodh që vargjet e dhëna mbi nënshtrimin i lexojmë: "Ah po, ja, edhe ca urdhra të tjera për gratë e shkreta, burrat janë rehat". Në fakt e anashkalojmë që të lexojmë pakëz më tutje thirrjen që Perëndia u bën burrave "duajini gratë tuaja!"

Kur isha vajzë e pamartuar, i kuptoja krejt ndryshe vargjet e mësipërme. Ndërsa vitet rrodhën dhe bashkë me martesën erdhën edhe fëmijët, kuptova që Perëndia kishte "fshehur" shumë urtësi në këto urdhërime. Këtë gjë vazhdoj ta kuptoj edhe tani, sidomos nëpër diskutimet që ne bëjmë mes shoqeve.

Por si mund të tregojmë respekt dhe nënshtrim ndaj bashkëshortëve tanë në ato raste kur ne nuk biem dakord në çështje të mëdha, siç janë: shëndeti,

ushqyerja, stili i jetesës, vendimi se ku do të jetojmë, si dhe ku do t'i shkollojmë fëmijët tanë, si do t'i administrojmë të ardhurat familjare etj.?

Nënshtrim nuk do të thotë shtypje, megjithëse termi "nënshtrim" (lexo: shtypje) për lëvizjen feministe në vitet 1950 nënkuptonte shtypje. Perëndia ynë, Krijuesi i gjithçkaje, nuk ka dashur kurrë që tek gruaja të shpalesë tiparet e një krijese të "humbur". Ai na ka pajisur ne me disa aftësi për të cilat bashkëshortët tanë kanë nevojë dhe i ndihmojnë ata për të marrë vendimet e duhura, duke i dhënë lavdi Perëndisë në çdo gjë.

Nënshtrimi vjen butësisht, pasi nënkupton që ti heq dorë nga diçka në çastin që kupton që, nëse dëshiron që të ecësh përpara në jetën në çift, dikush duhet të heqë dorë nga e vetja. Kjo nuk do të thotë që idetë dhe mendimet e

tua janë të pavlefshme, por që ti nuk po kërkon merita. Kjo është ajo çka bashkëshortët ndiejnë shumë herë kur ndodh një mosmarrëveshje mes tyre, pasi gjatë zënkave ata pozicionohen si armiq mes tyre, duke u përpjekur që të vërtetojnë argumentet e tyre. Në çastin që mes bashkëshortëve gjendet zgjidhja, atëherë mes tyre fillon të sundojë një situatë çlirimi.

Nëse ne e vlerësojmë këtë ndjesi paqeje dhe çlirimi që vjen prej Zotit, duke e pasur parasysh këtë fakt, nënshtrimi (që jo gjithmonë arrihet lehtësisht i arrihur) bëhet më i lehtë.

Nuk duhet të harrojmë që në çdo situatë të këndshme apo të pakëndshme (nëse çifti ka fëmijë) veprimet, fjalët dhe reagimet apo qëndrimet tona janë një Bibël lehtësisht e lexueshme për fëmijët tanë.

Si e trajtojmë ne njëri-tjetrin kur jemi vetëm? Po në prani të fëmijëve tanë? Si e "etiketojmë" ne njëri-tjetrin?

Një nga nevojat më të mëdha të një mashkulli është nevoja për t'u ndier i respektuar dhe shumë herë ne nuk e kuptojmë këtë gjë, duke menduar se dashuria që ne i japim është gjithçka për të cilën ai ka nevojë. Ndaj edhe me veprimet tona, me dashje apo pa dashje, ne nuk i shprehim respektin dhe besimin që kemi tek ai.

Një nga mënyrat për të shprehur respektin ndaj bashkëshortit është nënshtrimi, megjithëse është diçka e cila nuk vjen në mënyrë të lehtë. Por ju plot respekt mund të thoni "Besoj tek urtësia jote", ose "Unë mendoj ndryshe, por kam besim tek ti dhe do të të mbështes në vendimin tënd". Kjo do të thotë shumë për bashkëshortin tënd dhe për fëmijët tuaj. Ata do të shohin një nënë që respekton babanë e tyre edhe kur ajo mendon ndryshe prej tij. Do të shohin se si ajo shtron shembullin e një gruaje të perëndishme përpara bashkëshortit dhe fëmijëve të saj.

Nëse jeni nënshtruar, atëherë vazhdoni të jeni e tillë deri në fund, edhe kur gjërat nuk shkojnë ashtu siç e prisni dhe mos përdorni thënien e shpeshtë "A nuk të thashë unë?" Nëse ratë dakord me mendimin e tij, çdo reagim apo koment tregon që ju nuk e keni pasur me gjithë mend nënshtrimin tuaj.

Nëse ju e trajtoni bashkëshortin tuaj si të paaftë e të paarsyeshëm, çfarë do

të mendojnë fëmijët tuaj për të? Si do të ndihen ata për babanë e tyre? Si do të sillen ata me babanë e tyre?

Krijimi i besimit tek bashkëshorti juaj dhe krijimi i besimit të fëmijëve tek babai i tyre janë ndër gjërat e rëndësishme në jetën e një familjeje, sidomos kur flasim për familjet e krishtera.

Një kujtesë e mirë për ne është vargu i 1 Pjet. 3:1 "Gjithashtu edhe ju, gra, nënshtroni burrave tuaj, që, edhe nëse disa, nuk i binden fjalës, të fitohen pa fjalë, nga sjellja e grave të tyre".

Zakonisht në familjet shqiptare nënat kanë mundësi që të kalojnë më shumë kohë pranë fëmijëve të tyre. Duke qenë se ne jemi ato që u mësojmë gjuhën e folur (gjuha e mëmës) fëmijëve tanë, i mësojmë të ecin, të njohin botën përreth, u mësojmë Fjalën e Zotit (ne i prezantojmë fëmijët me heronjtë biblikë, me historitë e mrekullueshme të Biblës), i mësojmë të luajnë, të njohin e të shprehin veten e tyre, i mësojmë gjithashtu edhe për virtytet e cilësitë e baballarëve të tyre. Jemi ne ato që u rrefejmë fëmijëve tanë për pjesë të karakterit të baballarëve të tyre, që ata si fëmijë nuk i kuptojnë dhe nuk dinë t'i dallojnë dot ende.

Nëse ne flasim keq pas krahëve të bashkëshortëve tanë për dobësitë e tyre mes mikeshash apo me të afërmit tanë, çdo gjë që kemi "predikuar" në sy të fëmijëve, bie poshtë.

Fëmijët përçojnë mënyrën se si ne u drejtohem bashkëshortëve tanë në çdo situatë. Ata shohin tek ne shembujt e heronjve që duan apo nuk duan të ndjekin gjatë jetës së tyre. Nëse unë

si nënë nëpërkëmb babanë e fëmijëve të mi, atëherë edhe vajza ime do të mësojë që të bëjë të njëjtën gjë me vëllezërit e saj, me bashkëshortin e saj në të ardhmen dhe me djalin e saj.

Gjithashtu edhe djemtë e mi do të mësohen me nëpërkëmbjen dhe mungesën e respektit që unë shfaq ndaj babait të tyre dhe ata do të mësohen të pranojnë mungesën e respektit nga gratë e tyre në të ardhmen.

Sikundër Krishti është kreu i kishës, ashtu edhe burri është kreu i familjes dhe këtë nuk e them unë, por na e mëson Fjala e Zotit tonë.

Marrëdhënia jonë si bashkëshortë reflekton imazhin e Perëndisë, ndaj duhet ta trajtojmë e respektojmë njëri-tjetrin si krijesa të çmuara, të krijuara sipas shëmbëlltyrës së vetë Krijuesit.

Unë nuk jam një grua e përsosur, as bashkëshorte apo nënë e përsosur, por dëshiroj që fëmijët e mi ta shohin dhe ta respektojnë babain e tyre si kreun dhe autoritetin e familjes sonë. Ai është autoriteti ynë frymëror dhe vizionari i familjes sonë. Ai ka përgjegjësi përpara Perëndisë për jetët tona frymërore. Detyra ime si ndihmëse e tij është që ta mbështes, të lutem dhe t'i jap këshilla sipas urtësisë së Zotit në rastet kur ai ma kërkon një gjë të tillë.

Ju uroj urtësi prej së Larti dhe Zoti i dritave ju udhëheqtë në çdo hap!

Përzemërsisht,

Edi Gogu

Drejtuese e lëvizjes "PROFAMILJA"
Profamilja.wordpress.com

